



V. MOSKO

URANI RUMBO

92
—
463

VALENTINA MOSKO

URANI RUMBO

(Mësuese e Popullit)



23573

SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»

**«. . . Urani Rumbo, kjo organizatore e
shquar e arsimit dhe emancipimit të vajzës
gjirokastrite. . .»**

ENVER HOXHA

PARATHËNJE

Urani Rumbo është një figurë e nderuar në historinë e arsimit e të shkollës shqipe, si dhe të përpjekjeve për emancipimin e gruas shqiptare.

Shoku Enver Hoxha, duke përshëndetur popullin e Gjirokastrës, me rastin e ngritjes së obeliskut e të qendrës muzeale, kushtuar gjithë mësuesve e mësueseve, pionierë të arsimit, të shkollës e të gjuhës shqipe, e vendosi emrin e Urani Rumbos në plejadën e «mësuesve patriotë të nderuar», «të cilët duke ndjekur rrugën e Koto Hoxhit e të Pandeli Sotirit çelën, ... me përpjekje të mëdha, shkollën shqipe «Liria» dhe më pas shkollën «Drita»».

Duke qenë kështu, kuptohet se njohja dhe studimi i jetës dhe veprimtarisë së Mësueses së Popullit Urani Rumbo merr rëndësinë e një detyre të çmuar, të cilën poetesha e re Valentina Mosko është munduar ta realizojë me librin që po u paraqet lexuesve.

Urani Rumbo është nga të paktat gra intelektuale të dala nga gjiri i popullit, që në kushtet e robërisë së huaj e të pengesave të panumërta të rendit feudo-borgjez, punoi e luftoi me dashuri e guxim për lartësimin e shkollës shqipe dhe për të drejtat e gruas shqiptare. Puna e saj si mësuese dhe

punonjëse shoqërore la gjurmë të paharruara dhe dha frutet e veta në edukimin patriotik dhe formimin e shëndoshë të brezit të ri, sidomos të vajzave, në disa nga viset tona të jugut e në mënyrë të veçanë në krahinën e Gjirokastrës.

Në tërë veprimtarinë e vet, Urani Rumboja është udhëhequr nga parimet patriotike e demokratike. Duke jetuar në kohë të errëta, e karakterizuar nga atdhedashuria dhe shpirti i inisiativës, nga besimi në vitalitetin e popullit të thjeshtë dhe të brezit të ri, ajo ka punuar e luftuar për ta mbajtur ndezur pishtarin e diturisë e për të lehtësuar sado pak pozitën e rëndë të gruas shqiptare.

Lufta që ka bërë për hapjen dhe mbajtjen e shkollave shqipe, pasioni i zjarrtë i mësuesisë, metodat e përparuara për kohën, të zbatuara në procesin mësimor-edukativ, synimet për ta lidhur shkollën me jetën, besimi e kujdesi i posaçëm për arsimimin e lartësimin e vajzës shqiptare, nga njera anë, dhe nga ana tjetër, veprimtaria e gjithanshme shoqërore, si inisiatore e shoqatave arsimore-kulturore, si frymëzuese e teatrit dhe e muzikës në rrethet e rinisë shkollore, si autore tekstesh dhe artikujsh me tema pedagogjike-metodike etj. të gjitha këto zbulojnë personalitetin e Urani Rumbos.

Merita e këtij libri qëndron pikërisht në përpjekjet e suksesshme të autores për t'ia dhënë lexuesit në gjithanshmërinë e saj figurën e Urani Rumbos. Sigurisht Valentina Mosko këtë nuk e ka pasur të lehtë. Vetë hartimi i një biografie është një proces pune kompleks, që lidhet jo vetëm me hulumtimin e mbledhjen e materialeve faktike, me sistemimin e «rikonstruktimit» logjik e të argumentuar të jetës e të veprimtarisë së figurës, por

dhe me interpretimin dhe zgjidhjen e një vargu de-tyrash që nxjerr hartimi i biografisë.

Duke patur parasysh këto, kuptohet se autorja ka hasur vështirësi të natyrave të ndryshme, të cilat i ka kapërcyer me dashuri e devocion, me punë këmbëngulëse dhe durim.

Në mungesë të studimeve e të shkrimeve të mjaftueshme, kushtuar Urani Rumbos, të dokumentacionit të plotë e të sistemuar, autorja është përpjekur ta gjurmojë e ta mbledhë jetën e veprën e mësueses së mirënjohur në kujtesën e popullit, në kujtimet e kolegeve e të ish-nxënësve, në shtypin e kohës dhe në materiale të ndryshme arkivale.

Figura e Urani Rumbos është vendosur drejt në kohën dhe rrethanat historiko-sociale, në të cilat ajo ka jetuar e punuar. Autorja me të drejtë është ndalur në momentet kryesore të veprimtarisë së saj, duke i dhënë përparësi aspekteve shoqërore, të cilat përcaktojnë dhe fizionominë e vërtetë të Urani Rumbos. Në mënyrë të veçantë, V. Mosko ka treguar njohje të mirë të ambienteve fshatare të Lunxherisë, të mendimeve e të psikologjisë së vajzave të kohës.

Në libër bie në sy lidhja e ngushtë shpirtërore e autores me figurën që përshkruan. Ajo e admiron atë dhe kjo ka bërë që të mos qëndrojë indifereente ndaj fakteve, që përshkrimin e jetës dhe punës së Urani Rumbos ta shoqërojë në çdo rresht emocioni e stima e thellë për mësuesen e dashur të popullit.

Valentina Mosko nuk ka marrë përsipër të hartojë një biografi shkencore, por kryesisht një jetëshkrim letrar, bile pak a shumë të lirë nga paraqitja rigoroze e fakteve. Disa herë, ajo i ka dhënë vend

dhe krijimit artistik, duke pasur parasysh ngjarje e kujtime të bashkëkohësve. Sigurisht kjo e ka bërë veprën tërheqëse e të këndëshme në të lexuar, por në këto raste flet më shumë krijuesi, poeti dhe kjo s'ka si të mos zbehë deri në një farë mase vërtetësinë objektive të një paraqitjeje rigoroze e shkencore.

Disa herë autorja e dashuruar pas figurës së Urani Rumbos harron kufizimet e kohës, dobësitë dhe mungesat e botëkuptimit të mësueses patriotë, që lufton nga pozita iluministe; disa herë ajo e afron më shumë se sa duhet me kohën tonë, duke kapërcyer pa dashur ato kufij që ndajnë epokat historike apo stadet e zhvillimit të arsimit e kulturës sonë; ndonjëherë krijohet përshtypja se Urani Rumbo punon e vetmuar, ajo jepet e shkëputur nga përpjekjet e synimet e përbashkëta të mësueseve të tjerë përparimdashës.

Libri do të kish fituar më shumë sikur jeta e vepra e Urani Rumbos të ravijëzohej në një sfond social-historik më të plotë e më konkret. Një sfond i tillë do ta nxirrte më në pah figurën, do ta bënte më bindëse e më reale. Nga ana tjetër, kjo do të evitonte ndonjë notë panagjerike apo disa mbivlerësime, qoftë dhe për çështje anësore.

Megjithatë në librin e Valentina Moskos lexuesi do të gjejë një portret të gjallë të mësueses patriotë Urani Rumbos, dhe përmes saj, do t'i hapet një dritare në të kaluarën, për t'u njohur me përpjekjet fisnike të pionierëve të arsimit tonë, për një shkollë shqipe kombëtare e të përparuar ku një vend nderi zë dhe vajza fshatare nga Lunxheria.

Nasho Jorgaqi

«ZËRI I PASTËR IU DËGJOFTË. . .»

Ato janë një radhë fshatra të bukura mbi faqen e malit të Lunxhërisë. Që nga Karjani, Erindi, Dhoksati, të bie patjetër në sy Stegopuli i vogël, rrëzë Korries.

Ishte jetë e rëndë, nën regjimin e Turkut. Të 70 shtëpitë e Stegopulit, nën çatitë me dërrasë të bardhë, qëndronin mes blerimit të faqes së malit, të heshtura, të menduara. Çdo shtëpi dukej e mbyllur në vetvete, e mbytur në punë e në taksa, që u rëndonin jetën. Ditën fshatarët rropateshin në punë të rënda për të jetuar dhe vetëm darkave mblidheshin ca burra në Rrepet e Konakut; këmbenin ca biseda, si për të shpërndarë disi lodhjen e ditës, dhe pastaj mbylleshin brenda.

Kështu kalonin ditët një nga një. Ditë të ngarkuara me lodhje, me varfëri, me taksa të rënda, që u bëheshin fshatarëve ferrë në këmbë e në sy. Vinin dhjetarët nga qyteti me grykat e thasëve hapur: u rrëmbenin bukën fëmijëve, djersën fshatarëve. Duke mashtruar mbi paditurinë e tyre, ata bënin njëqind pazarllëqe. Dhe fshatarët, aty për aty, me guxim, kanë qëlluar rëndë me të tillë vargje popullore:

*Të tre dhekatarët
Ndërtur si manarët.*

*Këta s'janë dhekatarë,
Janë hajdut kumandarë¹⁾*

Mbi supet e stegopuljotëve veç dhekatisë rëndonin dhe vergjitë e xhelepet e rënda. Të gjitha këto ua bënë jetën fshatarëve më të zezë se nata dhe të atillë siç e shpreh këngëtari popullor:

*Vdiq Marina maj divanit
Për qejf të një dhekatarit,*

.

për të cilën më vonë kënga me dhembje të thellë do të shprehet:

*...Ah, ku je, e zeza Marinë,
Do të ta marrën hakën tinë;
Se vajtëm mu në Janinë
Për atë dhjetar jecinë
Dhe të gjithë eterinë²⁾*

Kjo gjendje e rëndë ekonomiko-shoqërore, shkaktuar nga pushtuesi turk e detyronte fshatarin stegopuljot, sikurse atë lunxhot, të revoltohej dhe këtë revoltë ta shprehte jo vetëm me pallë, siç bënte zakonisht, por edhe me fjalë:

① Vargje të shkëputura nga rapsodia e Nive Janaqit — shekulli i 19-të.

2) Shoqërinë

Të vemi në hyqymet
Lëshon djemtë e na vret...
— A s'kemi dhe ne të drejtë?.. 1)

Zëri i së drejtës në këtë varg është vazhde e zërit të fuqishëm për shekuj me radhë të popullit tonë për liri e drejtësi.

Akoma më të zeza kalonin ditët në ato shtëpi që e mbyllnin portën e jashtme me hekur që kur niste të errej pak. Ishin familjet stegopuljote pa burra në shtëpi. Burrat kishin marrë përtej detin. Linin në shtëpi nënat e nuset e reja shtatzëna, linin qetë në mes të arës e hidhnin në krah një trastë leshi. Ata nisnin kështu rrugët e pafund, rrugët «e fatit». Këto familje jetonin vetëm me disa çaste gëzimi a hidhërimi, që u sillte një copë letër e ardhur nga larg. Një pjesë e tyre vinte në një zarf të zi; të tjerët linin djersën, mundin e tyre në dhë të huaj duke menduar një të nesërme më të mirë. Por kjo dëshirë mbetej vetëm një ëndërr e porealizuar, se dheu i huaj çdo ditë u vidhte forcat, rininë e i mplak- te para kohe.

Gratë stegopuljote me atë durimin e shqiptar- kave të ndershme prisnin me vjete t'u ktheheshin burrat. Vetë lëronin, vetë mbillnin e korrnin, vetë rritnin dhe edukonin fëmijë të mirë. Vetë përba- llonin e mbanin mbi supe peshën e rëndë të zakonit, që e mbyllte të renë brenda shtëpisë.

Vetëm në ditët e festave të ndryshme do të njih-

1) Nga vargjet e këngëtarit popullor N. Janaqi kundër dhjetarit. (Dëgjohen edhe sot nga goja e popullit. Ato i gjen në muzeumin e Stegopulit).

je një stegopuljote tjetër: të qeshur, shtathedhur e zëbilbil. Dukej sikur ajo natyrë e bukur e fshatit kishte hyrë edhe në bukurinë e shpirtit, të fjalës e të mendimit të tyre. Sikur ai ajër e ujë i freskët kish ndërtuar bisedat e tyre të lirshme e të singërta. Këto ditë gëzimi ishin të rralla e të pakta për stegopuljotët. Dhe ditët e tjera vazhdonte ajo monotoni e varfërisë. «Herë-herë këtë monotoni e prishnin Z. Kornil Rumbo e zoti Kristo Rumbo, që ishte një plak i zgjuar e i mençur dhe shqiptar nga sjellja dhe karakteri...¹⁾).

Rumbajt ishin fis i lashtë në Stegopul; fis i gjerë dhe i përhapur në fshatrat e krahinës e jashtë saj. Bashkë me familje të tjera patriote i jepnin jetë e gjallëri fshatit. Kish burra të mençur mes tyre, të fjalës, të punës, fisnikë në traditën e hershme të bujarisë²⁾.

Aty, poshtë bregut të Goricelës, në një shtëpi të thjeshtë po me portë të madhe e me qemere, jetonte njeri djalë i Rumbos, Spiroja. Bashkë me Athinane, «nusen e mirë zagorite», siç thoshte fshati, bënin një jetë të thjeshtë. Spiroja, i arsimuar, punonte mësues, ndërsa Athinaja merrej tërë ditën me punët që kërkonte fshati.

Me kohë u krijua vatra e tyre familjare. Lindën me radhë fëmijët, që gjallëruan shtëpitë e shurdhëta: Kornili, Emilia, Thanasi. Në shtëpinë e Spiro Rumbos nisi të lëvizë jeta familjare me gëzimet dhe shqetësimet e saj.

1) Gazeta «Drita», 7 gusht 1920.

2) Po aty.

— Vajzë! — dëgjoji Spiroja zërat, nga dhoma tjetër. Atje ndodhej edhe nënë Frosa, «mami e dëgjuar». Athinaja kishte lindur vajzën e dytë dhe fëmijën e katërt të familjes.

Spiroja u ngrit në këmbë e, pa kuptuar, u nis andej nga erdhi zëri, kur i doli përpara nënë Frosa.

— Të të rrojë, Spiro, e të ketë këmbën e mbarë, pa çka se është vajzë! Ti bëre edhe djem plot. Të ketë njerëz shtëpia, more djalë. Hajde, t'i kesh gëzim e të rritet me prindër...

Dhe doli nga porta duke ua thënë këtë lajm gjithë atyre që takonte.

Stegopuljotët vanë në mbrëmje te Spiroja për ta kaluar bashkë këtë gëzim. Ishte zakon i lashtë e ruhej në tërë krahinën: gëzimet dhe hidhërimet kaloheshin me të afërmit dhe të dashurit e shtëpisë.

Shpesh, kur Spiroja vinte pas një jave që qe larguar në punë, përkulej te djepi i vajzës, me buzëqeshje, e pëshpëriste: «Shiko, shiko! Qan shumë ti, nuk e duron dot «padrejtësinë» që të bëhet kur të lënë lidhur në djep. Do që të jesh e lirë...», dhe qeshte; pastaj vrërej e rrinte i menduar, sikur të kishte marrë një vendim të heshtur në vetvete: «Vajzë dhe ti, me plot halle në jetë dhe me kokëçarje për prindin e shkretë...»

Ishte dhjetori i vitit 1895, kur lindi kjo vajzë. Kishin kaluar disa muaj nga koha kur edhe në Libohovën përball, një nënë libohovite kish lindur një djalë të quajtur Avni Rustemi.

Gjyshja e vajzës së porsalindur zgjidhte emra nga të vjetrit e fisit, që nuk rronin më, por që du-

heshin «ringjallur». Ishte zakon i trashëguar ky në gjithë krahinën. Gjyshja nisi të bëjë një bisedë më tepër me veten se sa me të tjerët.

Vështroi gjatë me sy të menduar dhe foli me zë të fortë si shpellë:

— Emrin tim do t'i vëmë, Urani...

Të gjithë kthyen kokën nga gjyshja. Ajo ishte akoma shumë e mbajtur.

— Po, po. Mos u çuditni fare. Kjo vajzë do të ketë emrin tim.

Iu afrua djepit, diçka i pëshpëriti me të lehtë foshnjës e, me një zë të zgjatur, i këndoi tek koka duke e tundur:

*«...Nina-nina, mbesa ime,
Fli e rritu, bëhu trime,
Pëllumbesh'e e dades ti,
Bëhu vajzë për zili.¹⁾*

.

U ngrit, u dha të gjithëve dorën, pastaj iu drejtua djalit:

— Të na rrojë, Spiro! Më e mira e të tërave të bëhet! Zëri i pastër iu dëgjoftë ngaherë...!

Kjo vajzë, që qante aq shumë sa qe e vogël, ishte Urani Rumboja.

1) Këngë popullore djepi e Lunxhërisë. Dade i thonë gjyshes.

F È M I J È R I A

Fëmijëria e Uranisë kaloi shumë shpejt shesheve e lizmave¹⁾ të fshatit.

— Uro, hajde shpejt, se ikëm! — dëgjohej zëri i moshatareve të saj.

Me një copë bukë në duar, të lyer me ç'të kishte aty në fund të dollapit, fëmijët shkronin nga Goricela, Burrima e Baros, Kreci, Kukuli²⁾).

— Dale, — i tha një ditë gjyshja. — Sot ke punë me mua.

— ...Dhe atë ditë nisën, si për gjitha vajzat e fshatit në atë kohë, qëndizmat. Kjo ishte një traditë e lashtë për gjithë krahinën. Bashkë me fëmijërinë Uranisë i kujtoheshin shpeshherë dhe gishtat e shpuar nga gjilpëra, si dhe gërnja e përhershme e gjyshes. Gjyshja qe sevdalleshë e madhe për punën e dorës dhe, si Emilisë ashtu dhe Uranisë, ua mësonte me merak të punuarit e hollë. Sa herë i gjente vajzat pa punë, ajo u lëshohej me shufër thane. Qe e rreptë gjyshja në sjellje, po shumë e dashur.

— Pa dale, dale, si e ke punuar? — i thoshte

1) Brigje e vende me hije e ujë.

2) Vende të bukura e të pjerrëta.

shkuf.

shpesh Uranisë. — Bobo, si nallbane, moj e zezë! Po si ta mësova unë?..! Dhe ia prishte që nga fillimi. Por edhe Urania kishte durim të fortë e sedër të çuditshme. Ulej me orë të tëra mbi gjilpërë sipas porosisë së gjyshes dhe s'e lëshonte punën nga dora derisa e mbaronte ashtu siç duhej.

— Si e ka emrin ai guri i gjatë mbi Brinjë, dade? — pyeste gjyshen Urania.

— Ta kam thënë një herë, moj/^rharomeno¹⁾, — i thoshte me të qeshur gjyshja: «Guri i Nuses».

— Po pse është Gur i Nuses dhe jo i ndonjë tjetri?

— Është histori e gjatë dhe e lashtë, moj vajzë. Thënë ma kanë dhe mua. Uh, më dridhet trupi, kur e kujtoj...

— Po tregoma, tregoma, dade, dua ta di.

— Oh, me gjëra të shkuara e të vdekura kërkon të mirresh? Hajde, qëndis; kjo është punë e mirë për ty dhe jo këto...

— Ç'ke ti, unë do ta mbaroj sot punën, ashtu siç e do ti.

— Heee, moj rodhe, të tëra do t'i dish; mos të të shpëtojë gjë! — Dhe niste t'i tregonte:

...«Nusja e re, sa që martuar, mori thesin dhe tërkuzën dhe doli brinjës të mblidhte bar mali e dru të thata për shtëpi. U nis bashkë me vjehrrën, që pa gdhirë mirë. Akoma pa mbushur dy ditë tek shtëpia e burrit, zakoni e kërkonte që nusja të mirrite malin përpjetë, për ta treguar veten të fortë dhe të denjë për atë derë ku kishte hyrë. Ky zakoni rëndë, e ka nismën të lashtë. Nusja bëhej për shtëpi-

1) që harron shpesh (shprehje dialektore).



E ëma i ati i Mësueses së Popullit Urani Rumbo


në e burrit një kafshë pune. Atë do ta priste dhe ta përcillte mali. E ajo vinte e kthehej e ngarkuar me dru e bar si një mushkë. Pleqve, që rrinin pezuleve të portave, nusja do t'u fliste dhe do t'u puthte dorën; ata thoshnin me gojën plot: «Kjo nuse do t'ua hapë derën». Edhe atë mëngjes ajo u ngjit malit. Ec e mblihdh, ec e mblihdh, arritën në majë të Bunavasë. T

— Ti ngjitu ca më lart — i tha vjehrra. Je e re dhe ke fuqi më shumë.

Që zakon edhe ky, që nusja e re duhej t'i bindej pa fjalë vjehrrës. Sepse qysh në vallen e nusërisë vjehrra i hidhte nuses në shesh sende të ndryshme dhe nusja, megjithëse pa shkelur kurrë te dera e burrit, duhej të këputej nga vallja dhe t'i nasqeriste¹⁾ ato, atje ku e kishin vendin e tyre. Provonte kështu në sytë e dasmorëve zgjuarsinë dhe aftësinë e saj si amvisë. Kështu pra, atë ditë, që sipas zakonisht nusja me vjehrrën kishin shkuar në mal për dru, vjehrra kërkoi nga nusja që ajo të hipte më lart në mal. Nusja, që ishte në provë nga vjehrra e saj, e bindur, u ngjit të mblihdhte më lart. U zgjat, e shkreta, të mirrte disa tufa bari, që ishin mu tek maja e Bunavasë. Dhe tek e kishte vështrimin të këthyer nga fshati, i shkau këmba dhe ra që andej. Që atëherë u ngrit ai guri i lartë mbi Bunava, që e shquajnë të gjithë që larg. Duket sikur ai gur u flet e u tregon njerëzve për nusen e re. Që atë ditë mori dhe emrin «Guri i Nuses».

Kjo ngjarje tragjike e gruas së re, që kishte rënë viktimë e varfërisë dhe e zakonisht të egër, hyri thellë në mendjen e Uranisë së vogël.

1) t'i vinte në veprim (shprehje e urrejtjeje)



— Sa keq! — tha Urania, duke gërgëlluar. — Po vjehrra ç'bëri kur erdhi në shtëpi?

— Vjehrra e qau me lot bashkë me njerëzit e tjerë të shtëpisë dhe i bëri nderet që duheshin.

— Po ç'janë këto zakone kështu, moj dade? Nga i di ti këto?

— Janë zakone të vjetra. I kanë lënë të parët tanë. Na ka ndarë zoti ne femrave në këtë anë, moj vajzë, dhe do bëjmë siç thotë ai.

Urania vazhdonte të bënte pyetje të panumërtat. I dhimbte shpirti për fatin e nuses së re dhe i bëhej një komb në grykë për ato zakone të rrepta që po mësonte. Shikonte gjatë «Gurin e Nuses» nga Goricela dhe dukej sikur i thoshte heshtazi: «Do të ta marr unë hakën!»

Gjyshja, e mërzhitur nga pyetjet breshër të së mbesës, u ngrit duke mërmërisur nëpër dhëmbë:

— Mëso punën e dorës, nikoqirinë dhe ul kokën e bëj si të thonë, se këto pret jeta e shtëpisë nga ti...

Ja thoshte gjithmonë këtë porosi, si të kish frikë se mos mbesa e harronte.

...Kaluan vite. Fëmijëria e bukur me lodra dhe të qeshura brinjave e hijeve, e me ato qëndizmat që ia mësonte gjyshja kaloi shpejt. Babai, Spiroja, që ishte mësues nëpër shkollat me klasa plotore, e futi vajzën në shkollën plotore me gjashtë klasë, në Filat të Çamërisë, ku ishte dhe ai vetë mësues.

Kishin kaluar disa vjet nga memorandumi i Bukureshtit, që kërkonte autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë, me shkrirjen e katër vilajeteve. Në këtë kohë ishte vendosur njohja e shqipes si gjuhë zyrtare, jo vetëm në administratën shtetërore, por edhe në institucionet arsimore.

Kur Urania e nisi shkollën, në shtëpinë e babait të saj, Spiros dhe në shumë familje të tjera të fshatit, kishin hyrë veprat e rilindasve të botuara në shqip. Nëpër familjet me pikëpamje patriotike qarkullonin librat e Naum Veqilharxhit, të folkloristit Spiro Dine e Thimi Mitko, të Konstandin Kristoforidhit që ngrinte zënë: «Ndë mos u shkroftë gjuha shqipe, nuk do të shkojnë shumë vjet dhe nuk do të ketë Shqipëri në faqe të dheut, as nuk do të shënohet më emri shqiptar në hartë të botës», të Sami e Naim Frashërit, Çajupit e Asdrenit e deri Alfabetarja e parë e gjuhës shqipe, botuar nga Shoqëria e Stambollit më 1879.

Urania, qysh vajzë e vogël, kishte mësuar gjuhën e pastër e të kulluar shqipe prej nënës së saj zagorite. Po kështu babai i saj, që ishte mësues, i kishte futur asaj në shpirt dashurinë për vendin e saj dhe për këtë gjuhë që përdorte e tërë krahina. Urania u ul në bankat e shkollës plotore që të mësonte shqipen e shkruar sipas Alfabetares, nëpërmjet fjalës së babait të saj. Gjatë gjashtë vjetëve të asaj shkolle, ajo arriti të mësojë me shkrim greqishten e detyruar, por tërë vëmendjen ajo ia kushtoi mësimit të gjuhës së dashur mëmë, dhe librat e shqipes nuk i ndante nga dora as gjatë muajve të pushimeve të verës, kur kthehej në fshat.

Ishte nxënëse e vullnetshme dhe qysh në këtë moshë tregoi prirje të veçanta për letërsinë, sidomos për poezinë. Që atëherë vjershat e mësuesit patriot Koto Hoxhit dhe Çajupit ishin bërë vargjet më të dashura për të. Shpesh i vinte dades pranë dhe ia thoshte me zë të lartë vargjet që mësonte përmendsh:

«...O, moj (grua) zeza,
Ç'e do burrë zinë,
Që ftohet në krua
Dhe ti mban shtëpinë...»

— E, të pëlqen, kjo, dade?.. E ka thënë Çajupi nga Zagoria e mamasë.

— E... çka! — i thoshte ajo kot. — Mbarove tani?... Hajde, shpejt qëndizmën.

— Jo, jo! Dale njëherë...

Vetë natyra e saj kureshtare dhe e etur për dituri bëri që, qysh në moshë shumë të re të dijë e të kuptojë shumë probleme. Ajo e kuptonte domethënien e madhe të atyre vargjeve të cilat flisnin për jetën e rëndë të gruas, që ajo e shihte para syve të saj çdo ditë.

Shpesh vëllai i saj i madh, Kornili, sapo hynte në shtëpi, po ta gjente duke lexuar diçka fshehur, për ta ngacmuar, ia rrëmbente librin nga duart.

— Mjaft lexove tani, ik bëj ndonjë punë andej!

— Ç'ke ti që na jep mendje, e di vetë unë! Po bjere librin!...

— Nuk është për ty libri, je akoma e vogël — i thoshte ai. — Kur të rritesh dhe ca, aherë merru me to, se tani s'kupton gjë.

— Mos u merakos, nuk marr trutë e tua të lexoj. Me këto që kam do të lexoj e do të kuptoj. Po bjere tani, mjaft me shaka të tilla.

Dhe zënka vazhdonte deri sa ndërhynte babai, Spiroja. «E do librin — mendonte ai, i kënaqur nga e vogla. Është e gjallë dhe e sigurt në vetvete kjo vajzë. Ja, i lexohet në sy kjo gjë».

«Këndo, këndo dhe ca sa je e vogël, — mendonte gjyshja e Uranisë. — Sa të rritesh dhe ca, pa


ma merr të keqen. Do të mbyllesh brenda në nikoqiri, siç u ka hije vazave...»

Dy vjetët e fundit të shkollës plotore (1908-1909), ishin vite që, me rrjedhën e tyre historike, do të ndikonin mbi formimin e Uranisë.

Menjëherë pas shpalljes së kushtetutës turke, patriotët e njerëzit përparimtarë në Gjirokastrë vendosën krijimin e klubit «Drita». Pleqësia e klubit ngrinte me forcë nevojën e zbulimit dhe të mësimit të historisë sonë kombëtare, kërkonte që të hapeshin mësonjëtoare në qytet e në fshat, të pastrohej gjuha shqipe nga fjalët e huaja, të mësohej e të përvetësohej muzika shqiptare¹).

Klubi «Drita» përhapte idetë që, për zgjimin kombëtar populli duhej të njihej e të lidhej me historinë e tij të lashtë, të luftrave për liri dhe të përhapte gjerësisht gjuhën amtare. Themeluesit e këtij klubi ishin patriotët më të mirë, anëtarë të komiteeve të fshehta, si Çerçiz Topulli, niciatorë të shoqërisë «Kandilja» si Kaço Topulli, Hysen Hoxha, Andrea Konomi etj. Ishin anëtarët e këtij klubi që krijuan mbështetjen dhe vendosën hapjen e shkollës së parë shqipe në Gjirokastrë. Edhe shkollat e reja që u hapën më vonë në fshatrat Labovë, Libohovë etj. u vunë nën drejtimin e klubit.

Pikërisht në këto vite, kur, mes të tjerash, Kongresi i Manastirit (nëntor 1908) vendosi që si alfabet «të merrej Abeceja e Stambollit e, bashkë me të, dhe një Abece thjesht latine, që të përdroreshin bashkarisht mes shqiptarëve»²), Urania përvetësoi në mënyrë të përsosur gjuhën e shkruar shqipe. Në

1) Arsimi popullor (Nr. 6 — 1962. 

2) Histori e Shqipërisë, pjesa e dytë, f. 295.

këtë kohë asaj nisën t'i çelin dëshirat e para për t'ua mësuar gjuhën edhe gjithë fëmijëve të tjerë të krahinës.

Vetë babai i saj, Spiro Rumboja, për fëmijët e tij dhe për shumë nxënës të tjerë, pat qenë një mësues i tillë.

Nën ndikimin e punës që bënte i ati si dhe të dashurisë së saj për popullin e vet, ajo i vuri vetes një detyrë të rëndësishme: përhapjen e gjuhës amtare.

Luftën për gjuhën shqipe, që ishte në fakt një luftë politike kundër pushtonjësve turq e synimeve shoviniste të shteteve fqinj, Urania e kuptoi drejt dhe e përkrahu që në gjirim e familjes.

MBRESË E FORTË

Babai ulej shpesh me xha Kristaqin, kafexhinë e një kafeneje në Gjirokastrë, tek kanapeja nën hijen e pjergullës e të fikut të madh të oborrit. Biseda e tyre vërtitej tek komitët e tjerë që ishin futur në çetën e Çerçiz Topullit e të Mihal Gramenos e që luftonin haptazi kundër Portës së Lartë. Pastaj ndalonin gjatë tek ajo përpjekja e marsit 1908 në Mashkullorë, në të cilën forcat e Çerçizit, edhe pse të rrethuara tek hani i vjetër, nga forca të shumta turke, çanë rrethimin, pas një ditë lufte të ashpër, duke lënë të vranë vetëm Hajredin Tremishtin. Në mbyllje të këtyre bisedave Spiroja e ngrinte zërin: «Na zuri frymën ky turku. Të shporret që nishan të mos i mbesë!»

Këto fjalë regjistroheshin në mendjen e Uranisë.

Ishte fillimi i qershorit të vitit 1908, kur, papritur, një mbrëmje u hap lajmi në fshat se në stanet, mbi Revani të Libohovës, ishte bërë një përpjekje me armë me nja 200 ushtarë turq. Lajmi erdhi nga Libohova dhe për të po flitej portë më portë në ato mbledhjet paradarkore, gjoja si për të pritur bagëtinë. Përpjekja kishte zgjatur gjer në darkë. Po një ditë pas kësaj përpjekjeje çeta e Çer-

gizit u mirëprit nga populli i Suhës dhe, duke dashur të bëjë lart Grykës së Selckës, ishte kthyer përsëri ndanë lumit të Suhës, tek një mulli, pse një ushtri turke po varej nga gryka e Selckës¹⁾.

Mullixhiu selckjot, që i njohu trimat, i strehoi ata, u dha të hanë dhe i ruajti vetë që të pushonin gjatë natës.

Të nesërmen çeta u ngrit lart në Stegopul. Ata zunë vend tek sheshet mbi manastirin e fshatit dhe atje ushtoi kënga patriotike.

Portat stegopuljote filluan të çelen një nga një. Porta e parë që u çel ishte ajo e Rumbos. Spiroja i shoqëruar nga fshatarë të tjerë, u nisën sipër në manastir për t'u takuar me trimat e rrallë.

Ata i priti vetë Çerçiz Topulli. Ai u foli për domosdoshmërinë e luftës së armatosur kundër turkut si dhe për përhapjen e madhe të lëvizjes popullore. Pinë bashkërisht dhe kënduan. Aty nga darka nisi një shi i fortë. Një pjesë e stegopuljotëve e kaluan atë natë bashkë me trimat e Çerçizit në dhomat e manastirit. Me bujarinë që e ka karakterizuar brez pas brezi këtë krahinë, për luftëtarët e lirisë, të gjithë së bashku kaluan një natë të paharruar. Aty u ngrit dollia për lirinë e mëmëdheut, për trimat. Aty u ndez prush kënga patriotike dhe kënga e shtruar lunxhote. Atë natë trimat folën për përpjekjen e Mashkullorës e për vrasjen e bimbashit turk. Pastaj në një faqe të murit të divanit të manastirit luftëtarët vizatuan shkabën e zezë dykrenare, simboli i kombit dhe i lirisë, tamam si shkaba me shpatë e topuz që ishte dhe gjendet dhe sot në

1) M. Grameno. «Kryengritja shqiptare», dhe kujtime të popullit në muzetë Suhë, Stegopul, Selckë.

portën e qemertë të këtij manastiri e që tani është monument kulture.

Pas dy ditësh luftëtarët u nisën fshatrave të Lunxhërisë, siç i kujton edhe vetë luftëtari M. Grameno: «Lunxhëria është një vend i bukur, me fshatra të bukura e të pasura, me njerëz të ditur dhe me ujëra shumë. Kështu pra, kishim vendosur të përndaheshim për t'u organizuar më mirë...»¹⁾

Atë mbrëmje në fshat u bënë biseda të gjalla për atë takim me luftëtarët.

Në mendjen dhe në veshët e çdo stegopuljoti gjëmonin akoma fjalët e Çerçizit:

«Barut, plumba e deka ka ngrënë përherë shqiptari, por të qara, dacka e të rrahura kurrë s'e ka pasur zakon të hajë. Kjo e vërtetë është provuar gjithnjë, sa herë që e ka prurë puna. Ne dimë fort bukur të vdesim me nder dhe kurrë s'qasim të rrojmë nën shkop...»²⁾.

Fjala e tij i vinte njerëzit në mendime, u ndizte zjarr ndjenjën e pastër të atdhedashurisë. Atë natë llamba e biseda në familjen Rumbo u mbyll shumë vonë. Atë natë në mendjen e në ndërgjegjen e Uranisë u hap një dritare e madhe. Në shpirtin e saj kumboi një tingull, që më vonë do të bëhej një zë i fuqishëm.

Dita tjetër solli ndodhi të reja në fshat. Aty nga dreka erdhi në Rrepet e Konakut në Libohovë një grup turqësh prej 7-8 vetësh. Vajtën me mudirin (kryeplakun) dhe në manastir e panë shkabën e vizatuar në mur të divanit dhe e prishën me gjithë

1) Mihal Grameno. «Antikat kombëtare».

2) Nga kujtimet e fshatarëve. (Jani Mosko, Kiço Papa-vangjeli).

suva, morën pastaj ca fshatarë në pyetje, lexuan një shkresë, që e sollën vetë, dhe pastaj thanë:

— Ku e ka shtëpinë Spiro Rumboja...?

Turqit hynë me forcë në shtëpinë e mësuesit, e, pa folur asnjë fjalë, nisën të kontrollonin, duke përmbysur e flakur tutje gjithçka. Spiroja nuk ndodhej atë çast aty. Gjyshja, pa rënë në sy të tyre, e nxori Uraninë në oborr e i tha:

— Shko gjej babanë, moj e zezë! Këta zorzopë kanë në mend të na hedhin shtëpinë në shesh.

Sakaq Spiroja erdhi.

— Përse e bëni këtë kontroll në shtëpinë time?

— pyeti ai. Ata e panë në sy, me ca fytyra të skuqura nga vapa dhe të egërsuar, po nuk i kthyen asnjë përgjigje. Kaluan kështu në çdo dhomë duke hedhur në mes të saj çdo gjë që u zinte dora. Kur u erdhi radha librave, tek ai rafti i dhomës së madhe, ata zunë t'i hedhin edhe ato me egërsi nëpër shesh. Urania gati sa s'qante. Ajo nuk ia ndante sytë babait, që nuk po ndërhynte për këtë gjë. Babai ndiqte me vëmendje çdo lëvizje të tyre dhe vetëm heshtte. Atëherë vajza s'e përmbajti dot veten e duke qarë u lëshua drejt librave:

— Mos i hidhni ashtu, se u çorrën... Nuk i shihni? Ç'keni me librat ju?

Gjyshja e tërhoqi nga dora dhe e nxori jashtë.

Kontrolli vazhdoi edhe tek shtëpia e doktorit të fshatit. Tani gjithçka ishte e qartë. Ata kërkonin të gjenin gjurmët e çetës së Çerçizit. Kërkonin gjurmët e trimave të tij. Por si vallë? Trimat e lirisë tani kishin hyrë në mendjen e zemrën e çdo fshatari dhe ata s'do të arrinin t'i gjenin dot kurrë.

«Hë, si kofini pas të vjelit puna juaj, more të shkretë. Aty mbahuni, se do t'i gjeni. Po ata kanë

krahë, mor derdemena; krahë shqiponje me ëndrrat dhe dëshirat e gjithë popullit. Dhe shqiponjat nuk zihen lehtë në këto male» — thoshnin përbrenda fshatarët, tek i shihnin turqit që vinin rrotull shtëpive të fshatit. Pastaj dolën të gjithë majë Goricelës për të bërë sehir se si iknin turkoshakët më tëposhtë rrugës për Suhë. Hë, ikshi për gjithmonë, ishalla, se na morët shpirtin. Këmba dhë mos ju zëntë! — shanin me radhë fshatarët me një duf të brendshëm.

Moshatarët iu mblodhën rreth e qark Uranisë së vogël dhe e mbytën me pyetje. Ajo, me krenarinë që i lejonte moshën, u tregonte pa pushuar për kontrollin pa bërëqet që bënë turqit e liq. Kjo bisedë zgjati gjer në mbrëmje. Fëmijët dëgjonin me admirim rrëfimin e saj. Në sytë e tyre po rritej një shoqe trime, e dashur, e mënçur.

«...DUA TË MËSOJ...»

Bashkë me verën e vitit 1910 për Uraninë erdhi edhe mbarimi i shkollës plotore. Ashtu si në gjithë vendin edhe në fshatin e saj ishte rritur e kishte marrë përpjesëtime të gjera ndërgjegjja kombëtare kundër turkut. Këtë situatë e favorizonin kryengritjet e armatosura thuasje në tërë Shqipërinë. Perandoria Turke ishte duke u kalbëzuar.

Tani Urania ishte 15 vjeç. Ajo dinte mirë greqishten e re, me të folur e me të shkruar, pak nga greqishtja e vjetër dhe diçka nga latinishtja. Këto ajo i kishte prej babait të saj.

Vajza kishte pasion të fortë për mësimin e gjuhëve të huaja. Në këtë moshë ajo nisi të hedhë vargjet e para, që më vonë do t'i bëhen këngë. Burim i

Kur e mbaroi shkollën plotore 1910

fuqishëm frymëzimi për të ishte poezia popullore dhe letërsia artistike shqiptare.

Por koha nuk ecte aspak përshtat me prirjen e dëshirën e Uranisë. Koha kërkonte që vajza të mbyllej brenda, duke i mbytur çdo të drejtë shoqërore, domosdo edhe shkollën. Asnjë nga vajzat e fshatit nuk kish vajtur në shkollë të madhe e, as që mund të guxoje të mendoje një gjë të tillë. Ky ishte shkaku që, edhe mendimi i shumë pjesëtarëve të familjes, ishte se asaj, ashtu siç u veprua edhe për motrën e madhe, Emilinë, i mjaftonin gjashtë klasë. Për ta Urania kishte ardhur në moshë, si gjithë vajzat e tjera që arrinin dhjetë-dymbëdhjetë vjeç, ajo duhej të mbyllej brenda, të bënte punë shtëpie e të mendonte për familjen e re që do të krijonte. Por syri dhe mendja e Uranisë shikonin përtej këtyre caqeve të ngushta. Kjo gjë bëri që një natë gushti, në familjen e Rumbajve të pëlcasë një grindje e madhe, gjë që ishte e pazakonshme për këtë familje.

— Ti u rrite, moj Urani, s'ka më lezet të brendhësh shkollave. Plot di. Vajzës s'ka ç'i duhet shkollla e madhe për shtëpi. Ç'pësuam ne që s'dinim gjë? U rritëm juve e mbajtëm shtëpinë. Dhe ju si ne do të bëni... — i fliste pa pushuar nënë Athinaja.

— Ç'është kjo mënxyrë me ne, — vazhdonte dadeja — në vend që të mbyllesh vetë brenda, se të mbyll moshë vetë, dashke shkollë! Rri, moj vajzë! S'do të nxjerrësh bri ti, në tërë fisin tonë. Dhe, shiko këtu: — iu drejtua me zemërim — në të dhashë emrin tim, mendova të bëhesh nikoqire e mirë dhe jo kështu.

— Do të bëhem një herë nxënëse e mirë dhe pastaj nikoqire e mirë, — ngulte këmbë Urania.

— Po ç'ke që na hap avaze, moj vajzë? Ç'është

kjo shkollë që t'u ferros në kokë! Nuk i durojmë dot fjalët e botës për ty e për ne. Kemi qenë me nder gjer tani në tërë fshatin, — i thoshte përsëri nënë Athinaja.

— Nuk do të na bjerë nderi nga shkolla, moj mama, po do të na rritet — muntohej t'i mbushte mendjen Urania.

Grindja vazhdoi gjer natën vonë. Spiroja me dy djemtë e mëdhenj nuk ishin në shtëpi. Vetëm të shtunat e të dielat mblidheshin të gjithë bashkë. Emilia me Mitron, vëllanë e vogël, thuajse nuk hynë fare në këtë bisedë. Gjyshja ua preu që në fillim të drejtën e mendimit të tyre prej «axhamiu».

Urania atë natë nuk e mbylli synë fare. Ishte hera e dytë që e bënte një bisedë të tillë me mamane dhe po ndeshte tek ajo të njëjtën këmbëngulje. I vinte keq për veten, po dhe për mamane, që nuk po e kuptonte dot. Por ajo e dinte që edhe mamaja sillej ashtu sepse nuk kishte si të sillej ndryshe. Kështu ishin zakonet për vajzat dhe gratë. Dhe po ta thyeje këtë gjë, turpëroheshe për jetë. Ndjaj dhe nëna e saj s'guxonte.

Pa u gdhirë akoma mirë Urania kishte dalë nga shtëpia pa u ndier. Kur u ngritën njerëzit e shtëpisë në mëngjes dhe nisën nga punët, ajo nuk po dukej gjekundi.

Dita ecte, por ajo përsëri nuk dukej.

Pati edhe fshatarë që nuk përtuan të mendojnë e të flasin keq për të, sepse për ta ajo ishte tamam vajzë e rritur, për kalë.

Po ajo, pa rënë drita mirë kishte trokitur te porta e xhaxhait të saj, mësuesit të vjetër Petro Rumbos dhe, i kishte treguar gjithçka që kish ndodhur në shtëpinë e saj. Petroja, që e kishte vënë re

me kohë zgjuarsinë dhe vullnetin e madh për shkollë të mbesës së vet, e kuptoi mirë vajzën dhe mori përsipër ta ndihmonte.

Aty rreth mesditës, kur ktheheshin bagëtia për vapë, Urania u kthye në familjen e saj të alarmuar, bashkë me xhaxhanë, Petron.

— Pse na ike ashtu si hajdute, moj Uro? — i shfryu e para dadeja.

— Epo, ishte mysafire tek ne sot, — u përgjigj aty për aty, por butë, Petroja, si për të krijuar një ton të ri bisede.

— Po të mos thotë fare kjo vajzë nga vete? — tha nënë Athinaja.

— U tha e u tha plot mbrëmë, po ju nuk i dhatë të drejtë, prandaj sot,... — zgjati zërin Petroja.

— Ajo kërkon të vejë në shkollë, po i bën hesapet pa hanxhinë, — plotësoi gjyshja.

— Nuk e mendon se edhe ekonomikisht nuk e përballojmë dot shkollën e saj? — shtoi nënë Athinaja.

Urania, që gjer atë çast rrinte pa hapur gojë, këtu s'u përmbajt:

— Nuk është ky shkaku, mama; ti e kupton mirë. Ju do të dërgoni në shkollë të mesme Mitron e vogël. Me se do ta mbani?...

— Po që nga kjo, Uraninë do ta ndihmoj edhe unë. Ajo duhet ndihmuar nga të gjithë, — përfundoi Petroja.

Biseda u hap përsëri kur u kthye në shtëpi Spiroja me vëllain e madh Kornilin. Pas diskutimeve të gjata ata u bindën më së fundi që edhe Urania të shkonte në shkollë. Pas disa ditësh ajo, bashkë me Kornilin, u nis për në shkollën e mesme të Janinës.

Viti i parë i shkollës, 1910-1911, ishte i mbushur plot trazira e kryengritje kundër Perandorisë turke. Kjo ndihej shumë jo vetëm në Shqipërinë Veriore e të Mesme, ku me pjesëmarrjen aktive të Ismail Qemalit, Luigj Gurakuqit u formulua memorandum i Greçës për autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë, por edhe në Shqipërinë e Jugut. Kryengritja, që erdhi duke u zgjeruar sidomos në vitin 1912, u shoqërua me një zhvillim të gjerë të mendimit politik e shoqëror shqiptar dhe të lëvizjes letrare njëkohësisht.

Lëvizja letrare, që tashmë pasqyrohej gjerësisht në shtypin përparimtar demokratik të kohës, u bënte jehonë përpjekjeve titanike të popullit për çlirimin kombëtar dhe jepte kushtrim për kryengritje të përgjithshme. Të gjitha këto bënë një përshtypje të thellë në mendjen e Urani Rumbos që, edhe pse nxënëse e klasës së dytë të shkollës së mesme, ndiqte me interesim çdo gjë të re e përparimtare. Vjershat e M. Gramenos «Për mëmëdhenë», «Erdhi dita të luftojmë» etj., në të cilat shprehet hapur thirrja dhe besimi për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Vjersha këto që kishin arritur gjer në Janinën me plot shqiptarë e aq më shumë në shtëpinë e Rumbos, ndezën zjarr zemrën e vajzës së re.

Nëntori i vitit 1912 solli gëzimin e madh popullor: Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare. U realizuan kështu shpresat shekullore të popullit shqiptar. Ky akt i madh historik, u drejtohej jo vetëm politikës së fuqive të mëdha imperialiste të Antantës, por edhe monarkive të shteteve fqinje të Ballkanit. 28 Nëntori, kjo ditë e shënuar e Pavarësisë Kombëtare, hapi një etapë të re në historinë e Shqipërisë, etapën e shtetit shqiptar të pavarur.

Në ditët e fundit të nëntorit të vitit 1912 duke nisur që nga Vlora, Elbasani, Kavaja, Peqini, Lushnja, Durrësi, Tirana, edhe në Gjirokastrë valoi krenar mbi kalanë madhështore të qytetit, flamuri shqiptar me shkabën dykrenore.

Mësuesi i këtij qyteti, Thoma Papapano, mes të tjerësh, përshëndeti dhe ai me një fjalim të shkurtër dhe mjaft emocionues këtë ngjarje të rëndësishme për gjithë popullin.

Për këtë ngjarje të shënuar gëzoi edhe Lunxhëria e patriotëve të shquar rilindas, gëzoi edhe Stegopuli, që dikur kishte kaluar çaste të paharruara rreth flamurit të Çerçizit me shokë, te oborri i thellë i manastirit, gëzoi edhe zemra e Uranisë, që ishte akoma një nxënëse shkolle. Ajo që dikur kish parë nga maja e Goricelës së bashku me bashkëfshatarët e saj, ikjen e turpshme të turqve tatëpjetë Grykës së Selckës, Qafës së Xhandarëve, Udhës së Madhe, Suhës e që zbrisnin drejt Gjirokastrës, tani mbushte fletoret me vargje të guximshme. Ja ç'lexojmë në to:

*«...Pa dil, dilni Goricelë,
Shihni halldupët e mjerë
Si ikin me kokë vjerë,
Ulur e mbajnë maunxerë¹⁾,
Pa dollakë e rroba çjerrë...»*

Me ngjarje të tilla të mëdha politike për historinë e popullit tonë, ecte dhe mendimi, ndjenja dhe vargu i Urani Rumbos.

Vjetët e shkollës së mesme ishin vjetët që e lidhën më tepër me librin, sidomos me veprat më të

1) maunxerë — lloj arme.

mira të letërsisë së huaj. Homeri e Virgjili ishin bërë autorët e saj të dashur. «Për luftërat e Trojës e për Penelopën, që priti aq vjet burrin me ndershmëri, na tregonte shumë herë kur mblihdheshim tok në vapë...» tregojnë bashkëmoshataret e saj fshatare. Çdo verë ajo kthehej në fshat. Kishte etje të madhe të lexonte e të informohej për çdo gjë të re. Ulej aty ndanë lëmit me një libër, pa çka se gjyshja shkulte faqet e u binte këmbëve se mos e shihnin ashtu burrat e mëhallës. Por për Uraninë tani kish lindur një shqetësim i ri. Asaj i rëndonte në shpirt fati i moshatareve të saj. Ato s'kishin të drejtë të dilnin nga shtëpia të pashoqëruara, s'kishin të drejtë të rrinin te Sheshi i Rrepeve të fshatit, ashtu siç s'kishin të drejtë të mësonin ose të lexonin diçka. Të shtypura nga padituria dhe mjerimi ato duhej të rrinin brenda, e të prisnin të trokiturit e ndonjë krushqari në derë, që do t'u kërkonte dorën për nuse. Sa keq, sa të varfra shpirtërisht do të mbeteshin ato! Ndaj shtëpia s'e mbante e ndaj niste rrugën Urania.

— Hajde edhe ti Emili — i tha Urania së motrës një ditë. — Mblidhemi tok tek Tasoja.

— Jo, jo, unë nuk vij dot, por edhe ti ik pa u dukur tek këta të shtëpisë. I dëgjova në mëngjes që bënin bisedën tënde. Ishte edhe ai Kiço magjistari i fshatit bashkë me ta...

Urania e mori me mend bisedën që mund të ishte bërë për të, ndaj, fshehurazi, kapërceu gardhin e kopshtit dhe iku. Ishte kohë vape. Zakonisht në këtë orë baballarët pushonin pak, dhe kjo ishte koha më e mirë për t'u takuar me një pjesë të çupërisë së fshatit.

«Ishte shtëpi me vajza familja jonë, ndaj mbli-

dheshim aty, të gjitha vajzat e dy lagjeve të mesit të fshatit. Aty vinte dhe Urania — tregon një shoqja e saj... — Qëndisnim, mësonim vjersha dhe ia merrnim nganjëherë këngës me të lehtë».

«Mbahj mend tregonte Fotinia, një shoqja e saj, që Urania na recitonte me pasion këto radhë:

*Bota që kur është zënë
Shqipëria gjallë ka qenë;
Pellazg' e thoshin më parë,
Më së fundi Shqipëtarë.¹⁾*

Pastaj vazhdonim këngë për flamurin, për Adriatikun, pa i lënë asnjëherë këngët e vajet për Koto Hoxhë Qestoratin. Vargjet për mësuesin patriot ishin bërë popullore dhe i dinte përmendsh gjithë masa e fshatarëve:

*Qiçi²⁾ në rrëzë të shkëmbit,
O dajan i gjithë vendit.
Qiçi brenda në kala,
Që flasje për fukara.*

*Ngreu, Koto, se të do vendi,
Se të kish lezet kuvendi.»*

— Sot u kam sjellë edhe një libër. Është shumë i bukur. Ti që di të lexosh greqisht e shqip, Zoicë, merre e lexoje...! — u tha vajzave Urania një ditë, tek ishin mbledhur bashkë të gjitha.

1) Vargje të Naimit.

2) qiçi = çelës.

— Jo, jo — u përgjigj Zoica me drojtje. — Unë... po unë e lexoj, po nuk e kuptoj ashtu siç duhet! Kurse ti, ti je e mençur vetë. Ja, na i thuaj ti; i kuptojmë nga ti edhe më mirë.

— Po pse keni frikë nga këndimi i librave vetë, moj motra? — u tha Urania. — Libri është dritare dhe dritarja veç dritës s'të sjell gjë të keqe.

Dhe Urania u lexonte librat e rilindasve të ndritur me atë gjuhë të pastër e të ëmbël shqipe, dhe në zemrat e vajzave të reja ndizej dashuria dhe krenaria për vendin e të parëve, për gjuhën e bukur amtare.

— E dini që në Shqipëri kanë nisur të mësojnë, të shkruajnë gjuhën shqipe nëpër shkolla edhe vajzat, shoqet tona?

Ato ngritën kokën dhe e panë në sy.

— Po, po. Në Gjirokastrë mësohet shqip. Edhe në Korçë, ku zilja e parë e shkollës shqipe tringëlliu nga dora e Pandeliut tonë¹). Aty është hapur edhe e para shkollë shqipe për vajza nga Gjerasim Qirjazi dhe motrat e tij Sevasti e Parashqevi. Ajo shkollë është bërë një «fole kombëtare»²) që përgatit patriotë të flakta.

— Domethënë mësojnë edhe vajzat në Korçë? — pyeti njëra nga vajzat mendueshëm.

— Po. Mësojnë në gjuhën tonë. Në gjuhën që kemi dëgjuar nga nënat tona, sapo hapëm sytë e që e dëgjojmë në këngët e trimave, që luftojnë nëpër male kundër armikut të zi.

Vajzat e dëgjonin me vëmendje të madhe dhe ia përpinin nga goja fjalët që thoshte.

1) Pandeli Sotiri nga Selcka e Libohovës.

2) M. Grameno, «Antikat kombëtare».

Tani Urania e kishte të qartë se ç'do të ndodhte me to. «Nuk kanë frikë këto nga dituria — mendonte me vete ajo — por janë të drojtura e të trembura nga zakoni».

Kjo ishte ndeshja e parë e Uranisë në luftën e madhe të mbrojtjes së të drejtave të gruas shqiptare.

Kur ishte në mbarimin e vitit të tretë të shkollës, ngjarjet historike që vijuan, si Lufta Ballkanike e vitit 1913 dhe Lufta e Parë Botërore, që nisi më 1914, e detyruan Uraninë të ndërpresë studimet e mesme në shkollën qytetëse të Janinës dhe të kthehet pranë familjes në fshat.

Vitet që mbeti në fshat qenë për Uraninë vite të një pune të madhe individuale për ngritjen dhe formimin e saj më të plotë. Si autodidakte ajo arriti që, veç greqishtes e latinishtes që i kishte mësuar në shkollë, të mësojë nga librat e babait e të xhaxhait të saj edhe italishten dhe pak frëngjisht. Këto i dhanë mundësi që të njihte veprat më të mira të letërsisë përparimtare të këtyre vendeve.

Në këto vite ajo i hyri plot pasion punës për të mbledhur materiale rreth jetës e veprimtarisë së mësuesve patriotë Koto Hoxhit, Pandeli Sotirit, Nane Petri Saraqinishtasit etj. Vetë Urania flet për këtë ndërmarrje të saj:

«... E ndiej detyrë e nder të madh që si lunxhote jo vetëm të di e të mësoj për Koton e Pandelinë, por të mundem të bëj edhe unë diçka në rrugën e tyre të ndritur...»¹⁾

Në këto vite me trazira të mëdha, kur krahina ishte nën pushtimin grek, Urania nuk e ndërpreu

1) Marrë nga goja e mësuesit Foto Rumbo (kushëri i Uranisë).

për asnjë çast, por duhet ta themi se e thelloi edhe më tepër luftën kundër zakoneve prapanike që e detyronin gruan shqiptare të kishte një pozitë të shtypur e skllavëruese në familje e në shoqëri. Këtë luftë ajo e nisi që nga marrëdhëniet e brendshme të familjes së saj dhe e shtriu deri në jetën e shoqeve të saj të fshatit.

Ashtu si Çajupi, që ironizoi jetën e burrave të fshatrave të Zagorisë, duke vënë krahas tyre punën drobitëse që bënin gratë, edhe kjo mbesë zagorite nuk ngeli pa thumbuar në formë shakaje, me vargjet e saj të para, ato që shihte në familje e në krahinë. Megjithëse në kuadër familjar vargjet:

*«O moj qollopitë, me djath' e me gjalpë,
Lum kush të gatoi, lum kush do të hajë,
Të gatoi nënë Athinaja me llërë*

*përveshur,
Të hajë babo Spiroja, këmbë mbi këmbë
i qeshur»*

flasin për një të vërtetë shoqërore në marrëdhëniet dhe vendin e gruas së atëhershme në familje.

Janë këto probleme që do të shqetësojnë më vonë shumë më tepër vajzën e re, e cila do të dalë në mbrojtje të gruas më hapur e më gjallërisht.

MËSUESJA E PARË E SHQIPES

Kulla e mësuesve
Ge

Rruga e saj si mësuese e gjuhës shqipe nis në vitin shkollor 1916-1917. Pushtimi ushtarak italian i territorit të Gjirokastrës, duke u nisur nga kërkesat e vazhdueshme të popullit për të mësuar në gjuhën kombëtare si dhe nga synimet e veta politike, u detyrua të lejojë të hyjë në shkolla gjuha shqipe; por krahas kësaj, do të mësohej njëkohësisht edhe italishtja.

Urania ishte në fshat kur u lajmërua se qe caktuar mësuese e gjuhës shqipe në fshatin Dhoksat. Ajo «diçka» që donte të bënte Urania si lunxhote në rrugën e ndritur të Kotos e të Pandeliut, filloi pikërisht këtu.

Prej këtij viti shkollor (1916-1917), nis përpjekja e organizuar e shumë bijve të fshatrave të vargmalit të Lunxhërisë, për përhapjen e gjuhës shqipe në popull. Mes mësuesve: Sevo Pesha nga Stegopuli, Aristotel Lafe nga Saraqinishta, Aleks Basho nga Qestorati, Petro Cama nga Dhoksati, Dhimo Boshnjaku nga Gjati, Sokrat Meksi nga Labova e Odries, Koço Hila nga Tërbuqi, Llukan Ndreu nga Humelica, Prokop Bezhani nga Lekli, Miho Deduli nga Labova e Odries, Leko Leka nga Labova e Odries, Petro

Xhavara nga Labova e Odries, Jakov Qendro nga Gjati hyri edhe emri e përpjekja e së vetmes mësuese të gjuhës shqipe në krahinë, e Urani Rumbos.

Kjo lëvizje e gjerë dhe masive, që gjeti shtrirje dhe fushë veprimi jo vetëm në fshat e në krahinë po dhe jashtë tyre, nuk kishte thjesht karakter gjuhësor, por në radhë të parë karakter të theksuar politik, kombëtar e demokratik: sepse këto shkolla u hapën kryesisht nga vetë populli, kundër shkollës që bëhej në gjuhë të huaj dhe në shumë raste financoheshin nga vetë populli. Kështu, populli i Stegopulit për dy vjet rresht e pagoi vetë mësuesin Sevo Pesha. Ky fakt kuptimplotë tregon qartë dëshirën e madhe të popullit tonë për t'u dhënë arsim fëmijëve të tyre me anën e shkrimit të gjuhës shqipe.

Lëvizja kishte karakter të theksuar patriotik, sepse, megjithëse mësimi i shqipes mësohej krahas atij italisht, këta mësues patriotë bënë që fëmijët e popullit të mësonin së pari dhe kryesisht gjuhën amtare. Kujtojnë dhe sot nxënësit e atyre viteve në Labovën e Libohovës se si i iknin «bonxhornos» (mësuesit të italishtes) nga dritaret dhe futeshin në mësimin shqip. Ndërsa mësuesi Sevo Pesha vetëm kur merrte vesh se kishte ardhur ndonjë karabinier në fshat, u thoshte nxënësve: «Tani futni abetaren shqipe ndënë bankë dhe nxirrni atë italishte». «Tërë kohën tjetër — thonë sot nxënësit e parë të tij — ne mësonim në abetaren tonë».

Në këtë lëvizje të gjerë dhe masive, në këtë radhë të gjerë mësuesish patriotë nga Lunxhëria, hyri dhe puna e Urani Rumbos, si mësuese e shqipes në Dhoksat.

Me një trastë me ca rroba e më tepër libra, me

porositë e vazhdueshme të gjyshes për të ruajtur shëndetin dhe me sy plot shkëndija, që prisnin të ndiznin zjarre, vajza doli nga shtëpia dhe u nis në rrugën e madhe e plot mundime për të ndriçuar mendjet e bashkëfshatarëve të saj të vegjël me gjuhën shqipe.


Kur kaloi tutje përroit dhe doli në majë të Ne-razit, ktheu sytë mbrapa dhe pa fshatin, shtëpinë. E pa gjatë, pa lëvizur nga vendi. Sa i bukur ishte fshati! Ajo koria plot pemë mbi Shkëmbin e Kuq e Gurin e Gjatë dukej si një kurorë e gjelbër e vënë nga dora e njeriut. Pamja e bukur e fshatit të lindjes, që linte pas, ia mbushte zemrën me një mall dhe dashuri të parrëfyer. Dhe pa e kuptuar as vetë, i lindën një nga një vargjet e thjeshta:

*...Sa i bukur je, o fshat,
Mbushur gjelbërim të mirë,
Kreci rrjedh ujë plot shëndet,
Koria ta shton bukurinë...*


Shumë herë, ndënë bregun e Goricelës, me një fletore e laps ndër duar, ajo kish ngritur këngë të bukura për fshatin. E pastaj mblidheshin tok me moshataret e i lexonin. Ato vargje qenë gonxhe që do të çelnin patjetër lule të kuqe; qenë gonxhe që paralajmëronin pranverën.

— Ti çoç i bën fap e fap këto këngë dhe i bën të bukura. Tërë si xha Nine Janaqi e Kiço Shuli¹⁾, që ta ngjisinin këngën mu tek rrije! — i thoshnin shoqet ngahera.

1) Këngëtarë popullorë nga fshati Stegopol, në shekullin e kaluar.



Urani Rumboja midis nxënësve të saj në shkollën femërore
në Vlorë.



Urani Rumboja midis nxënësve të saj në shkollën femërore
në Vlorë.

Pa e kuptuar fare, Urania kish kohë që rrinte me vështrimin e mendjen tek fshati, tek kujtimet e fëminisë. Buzëqeshi pak, sikur të ishte kujtuar për diçka dhe u nis.

Në orët e pasditës arriti në Dhoksat. Disa gra e plaka zgjasnin kokën përmbi gardhe e u thoshnin me ngadalë shoqeve: «Erdhi mësuesja e fëmijve tanë. Është vajzë e Rumbajve nga Stegopuli». Fshatarët e pritën mirë e me ngrohtësi të gjithë. Urania, që kishte një natyrë të dashur e të afrueshme, u miqësua shpejt me ta.

«Bënim dy herë në ditë mësim — kujtojnë nxënësit. — Në orët e Uranisë klasa mbushej plot. Ishte e kuptueshme. Ne donim të mësonim gjuhën tonë, gjuhën që na flasin nënat që në djep. Ndërsa, kur vinte ora e mësimi italisht, ne rrinim në klasë derisa na ndahej 50-60 derhem bukë dhe pastaj fshehurazi largoheshim fare. Për herë të parë ajo dha shqipën në fshatin tonë. Dhe ç'të dhënë! Fjala, sjellja, veshja, mendimi i saj të tërhiqnin e të bënin për vete menjëherë...»

Ky është një mendim i përgjithshëm për të nga ish-nxënësit e fshatarët dhoksanjotë. E thjeshtë, e dashur, e mençur, si ajo asnjë tjetër, — thoshnin për të. Në çdo shtëpi të fshatit hyri Urania dhe mblodhi nxënësit për në shkollë. Dhe kudo atë e pritën si në shtëpi të saj dhe e quajtën si vajzë të tyre. Vargjet e saj për këtë rast i bënë të tyre edhe fshatarët:

*...Hajde, mblidhuni në shkollë,
Fituam këtë liri,
Të mësojmë gjuhën tonë,
Si çdo komb gjuhën e tij.*

Ju vëllezër shqipëtarë
Të rroni në dashuri,
Ortodoks e myslimanë,
Të jini vëllazëri...»

Bojën e shkrimit, fletoret, librat ajo ua siguroi vetë nxënësve të saj. Mësimin ua bëri tërheqës e të bukur. Ajo i merrte me vete fëmijët dhe të gjithë së bashku bënë shëtitje të gëzuara nga lëmenjtë e fshatit, nga kroi i Dudit. Dhe pastaj, kur ktheheshin, nxënësit rrinin në radhë e të bindur, me mësuesen në krye e me këngën e flamurit në gojë:

«...Valo, valo, flamur,
Valo mbi male të bekuar,
Valo i mburrur, i lëvduar,
Brigje dhe fusha t'i mbulosh...»

Fshatarët dilnin në rrugë e i shikonin me admirim.

— Ku ishte me fëmijë, moj Urani? — e pyesnin të gjithë.

— Ja «Nga një çikë e nga një çikë, Sa të mësojmë gjimnastikë...», — u përgjigjej ajo me vargje gjithë e qeshur e duke përkëdhelur lehtë vogëlushët që i donte aq shumë. Pra, që atëherë, në klasat e saj, po hynin elementet e para të njëlloj edukimi fizik.

— Mirë e bëre. Nuk duan gjithnjë në klasë këta. Janë si shqerrat, që duan të brendhin lëndina-ve, — i thoshnin fshatarët.

— Këto shëtitje u forcojnë trupin, u freskojnë trurin dhe u rritin shtatin fëmijëve, — plotësonte mësuesja.

— Ti mos ec shumë, moj mësuese. Ruaje shëndetin tënd, — i thoshnin me dashuri të sinqertë dhoksanjotet, kur e shihnin të dërsitur e të lodhur në fytyrë.

— Edhe mua mirë më bën, si fëmijëve, — u përgjigjej ajo e qeshej e tëra.

Një ditë pranvere, kur fëmijët i kishin mbaruar orët e mësimit, Urania i lajmëroi nxënësit:

— Nesër do të bëjmë një shetitje në fshatin afër, në Qestorat.

Nxënësit, që ishin mësuar me shetitjet e organizuara bukur, u hodhën përpjetë nga gëzimi.

— Cilin na kujton neve ky fshat? — pyeti mësuesja.

— Koto Hoxhin, — u përgjigjën njëzëri nxënësit.

— Veç vjershave e këngëve për patriotin e madh, ne duhet të pregatisim edhe një kurorë me lule të freskëta — u tha mësuesja.

— Do të sjell unë lule, mësuese. Edhe unë... edhe unë.

— Kurorën do ta bëjmë me lule nga të malit. Lulet e maleve tona, që i ka shkelur vetëm këmba e trimit dhe kurrë e pushtesve. Me lule të tilla u bëhet kurora patriotëve si Kotoja, — tha me zë të prerë e me pamje të menduar mësuesja.

Dhe fëmijët i kuptuan fjalët e saj, i kuptuan shumë mirë. Prandaj rendën tërë mbasditen arave, brinjave e gërxheve dhe u kthyen me duart plot me lule të freskëta.

Atë ditë pranë varrit të patriotit, në 23-vjetorin e vdekjes së tij, fëmijët çuan në shenjë kujtimi e respekti lulet e malit; ata çuan vjershat dhe këngët në gjuhën amtare, për të cilën mësuesi patriot kish punuar aq shumë.

— Fëmijë të dashur — u tha mësuesja. — Koto Hoxhi ishte një mësues patriot, që punoi e luftoi tërë jetën për gjuhën shqipe, për ato gërma që ne i mësojmë në shkollë. Të mos ta harroni kurrë punën, penën e zërin e këtij patrioti, që tha për ju e për brezat që do të vijnë:

K. Hoxhi / Ju, o djem, do më kujtoni,
Kur të ngjalletë liria,
Po ç'të bëj-o unë i mjeri,
Që m'u mbyllë sytë e mia...

Kjo ishte një shetitje që la gjurmë të fortë në mendjet e nxënësve.

Urania hyri në zemrat e fëmijëve e të çdo familjeje dhoksanjote. Tani atë do ta gjeje mes fshatarëve në gazet dhe në hallet e tyre.

«Unë s'veja në shkollë, se isha trembëdhjetë vjeç e s'na linte njeri të dilnim në pragun e portës, — kujton një fshatare. — Por unë mësova të shkruaj e të lexoj nga vëllai im i vogël. Urania ua mësonte të vegjëlve gjuhën aq mirë, sa vëllai im i vogël i përsëriste gjithë ditën me pasion ato që mësonte në shkollë dhe nga ai mësova edhe unë në shtëpi. Në të rriturave Urania na mblidhte tek Amelikoja¹). Ajo na mësonte atje qëndizmat, tantellat, vjershat e këngët».

Megjithëse ishin ditët e fundit të vitit shkollor, Urania gjente kohë të shkëputej nga mësimet e të vente në ndonjë familje dhoksanjote që pregatiste dasmën e vajzës. Jeta e varfër e plot mundime i

1) Dhomë për njerëz të qeverisë, që vinin me detyra në fshat.

bënte fshatarët që të prisnin me padurim e të mbli-
dheshin në një gëzim të përbashkët, në të vetmin
gëzim të asaj shtëpie të vafër që martonte vajzën.
Në krahinën e Lunxhërisë ishte zakoni, ashtu siç
është edhe sot, që çaste gëzimi të tilla të kalohen
me rreth e me fshat.

Në këtë gëzim të përbashkët, mësuesja, që
s'ndahej kurrë nga fshatarët, e niste këngën vetë e
para:

O moj mëma shqipëtare,
Ti, moj mëmë që më rrite
Me se munde dhe më shite,
Dhe më shite në të huaj
Dhe më the që rri e vuaj.
Un' e mjera ç'faj të bëra?
Punët t'i bëja të tëra.
— Un'e zeza nuk e dija,
Pa s'të nxirrja nga shtëpia.
— Po ç'burrë më dhe, moj mëmë!

Ç'e do mall' e ç'e do gjënë
Kur s'ke burrë për të qënë!

ose

Vashëza në gur të lumit lan e qan.
— Ç'ke moj vajzë që ke qarë?
— Lanetin mëm' e babanë
Më dhanë burrë të marrë.

Këndonte bukur. Atë e ftonin në çdo dasmë, dhe
ajo e ndizte muhabetin me këngët më të qëlluara të
rastit nga krahina.

Ndodhte që dikush niste këngë dasme në gjuhë

të huaj, sidomos ata që vinin nga kurbeti. Urania ndërhynte aty për aty me këngë, duke ua përkthyer e kënduar vargjet me fjalë shqipe.

— Thojani këngës, zëbilbila, po në gjuhën tonë, — u thoshte ajo, — se jemi pranë fshatit të Kotos, që u tret si qiriri për shqipen. Ai nuk na e fal kurrë këngën në gjuhë të huaj.

Mbyllja e atij viti shkollor që një festë e bukur për gjithë fshatarët. Urania po mbyllte vitin e parë të punës së saj si mësuese e gjuhës shqipe. Atë ditë shkolla ishte mbushur me nxënës, prindër, këngë e valle.

Me një gaz të tillë u ndanë dhoksanjotët me mësuesen e mirë, që sapo kishte nisur rrugën e madhe.

Viti në vazhdim (1917-1918), e gjeti Uraninë mësuese të shqipes përsëri në krahinën e Lunxhërisë, por tani në fshatrat Nokovë e Mingul. Ajo njihej me këto fshatra që kur kishte qenë mësuese në Dhoksat, ndaj shumë shpejt hyri në zemrat e nxënësve të saj, që për herë të parë nisën të mësojnë të shkruajnë gjuhën shqipe.

Punën në këto dy fshatra e filloi atëherë kur qeveria italiane, duke parë zhvillimin e lëvizjes patriotike në gjithë vendin, nisi të ndryshojë taktikën, duke shpallur me një proklamata «pavarësinë e gjithë Shqipërisë», por «nën hijen e mbrojtjen e mbretërisë së Italisë». Kjo proklamata u lexua qëllimisht në Gjirokastrë. Duke marrë shkas prej saj, u hapën shkollat fillore ku do të mësohej edhe italishtja krahas gjuhës shqipe.

Të drejtën e mësimit të gjuhës shqipe, që Italia e dha në emër të «pavarësisë», Urania e shfrytëzoi sa mundi, jo vetëm në shkollë por edhe në masën e gjerë të fshatarëve.

Ajo u mësoi nxënësve e të rejave të rritura, vjersha e këngë shqipe dhe, kur e pyesnin se ku i gjente mësuesja gjithë ato, e kish gati përgjigjen:

*«...Të thoni, shoqet e mia,
Këto që mëson rinia
I ka bërë Urania
E Rumbos nga Lunxhëria...»*

...Ishte ditë e ftohtë, e 28 Nëntorit të vitit 1917. Urania mori nxënësit për shetitje. Arritën tek she-shi mbi kroin e madh të fshatit dhe të vegjlit, si zogjtë, u mbloodhën rreth mësueses. Ajo u foli bukur e me pasion për atë ditë të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Tani idetë patriotike kishin nisur ta rrëmbenin Uraninë. Ajo u kishte mësuar fëmijëve për këtë ditë të shënuar, vjershat për Koto Hoxhin, për «gjuhën shqipe, që ka hije, porsì dielli kur bie», për trimin e maleve Çerçiz Topullin që:

*«...Çdo rrezik që të dëgjonte
Mirrte masa trimërie,
Si luan në shesh luftonte,
Çeços arma i kish hije...»*

ose

*«...Përse luftoi trimi i ri
Lule Çerçiz Topulli?
Të shporrë armikun e zi
Të bëhen në Shqipëri
Turq, kaurë njëlloi,
Të jemi vëllezëri...»*

Dhe fëmijët i recituan ato vargje me pasionin që u kish hedhur në shpirt mësuesja e tyre. Më vonë në shetitjet e shpeshta të pranverës, ku Urania u bënte mësimin e natyrës, ajo me fjalët e saj të mençura e të bukura u ngjallte nxënësve ndjenjën e fortë të dashurisë për tokën, për vendin e të parëve. Kjo ndodhte në një kohë kur shtetet e mëdha ëndërronin e bënë plane grabitqare për të rrëmbyer nga një copë tokë nga Shqipëria.

Shkolla e Nokovës atë vit u mbush plot me nxënës. Atje vinin fëmijët që nga Minguli për të mësuar gërmat e dashura të gjuhës amtare nga mësuesja e parë e shqipes, në fshatrat e tyre. Dhe ajo s'lodhej kurrë me ta. Vështirësitë e para materiale i kaloi bashkë me fshatarët arsimdashës. Aty në shtëpinë e një plake nokovite, kalonte edhe të dielat, që të ishte pranë fshatarëve në çdo hall e në çdo gëzim të tyre. Llamba e saj fikej e fundit në fshat. Lexonte Urania deri natën vonë dhe vriste mendjen për të nesërmen e këtyre vajzave të mbyllura, me të cilat ajo sa kish nisur përpjekjet e një pune të vështirë. I mbli-dhte grup, dhe duke qëndisur bashkarisht me to, u fliste për Shqipërinë, për të ardhmen, për familjen e re.

Nokova e këtyre viteve, si i gjithë vendi, gjen-dej nën peshën e rëndë të pushtimit ushtarak italian, të parisë dhe sidomos në atë të autoriteteve kishtarë.

— Të pashë shumë herë të mbledhësh çupërinë, moj dhaskalicë, — iu drejtua një ditë një fetar i lartë, që kishte ardhur nga Mitropolia e Gjirokastrës. Atë e shoqëronte prifti i fshatit¹⁾ — Ç'u thua e ç'u

1) Prifti më vonë u dënua si armik i popullit.

mëson? Shiko se mos dilni nga udha, e të madhit zot.
— Bëri kryqin, lidhi duart dhe uli kokën sikur falej, sikur të kish përpara vetë zotin, dhe vazhdoi:

— Zoti ynë është i madh, shpirtgjerë, e i sheh të gjitha gjërat, ndaj kujdes, mos bësh mëkatë, bija ime!...

Urania buzëqeshi e i foli me qetësi të madhe:

— Mos u shqetësoni, uratë, veç rrugës me dritë e diell, nuk u mësoj gjë tjetër. U hap syrin vajzave tona të mira; u flak tutje natën, siç thotë zoti ynë, — shtoi me ironi.

— Rruga e zotit, rruga jonë, fjala e zotit ligj e urdhër për ne, — pëshpëriti lutjet hierarku nëpër gojë dhe iku bashkë me priftin si hije e zezë nëpër rrugën drejt kishës, ku ishte mbledhur fshati.

«Sa të butë e të sjellshëm këta njerëzit e zotit, si qengj e kanë fjalën, por si ujk punën!» mendonte me vete në ato çaste mësuësja.

Urania hyri vonë në kishë e qëndroi andej nga fundi. Prifti, që e vuri re ardhjen e saj, mbylli atë librin e trashë që kishte përpara dhe me zë të lartë, duke parë nga fundi, foli:

— Mëkatarët e zotit duan t'ju shtrembërojnë e t'ju heqin nga rruga e shenjtë. Ruajeni veten bijtë e zotit, që të gjeni prehje e të mos u shkojë shpirti në skëterrë.

«I flet dritares ky të dëgjojë dera... Domethënë ia kanë frikën kësaj pune», mendonte Urania.

Kur mbaroi kisha, gratë u mbledhën përreth Uranisë. Pas kishës ose në ndonjë dasmë a kësollë, krijohej mundësia për t'u mbledhur e për të biseduar me to. Edhe atë ditë, si shumë herë të tjera, mësuësja u hapi atë bisedë, që e kishte aq shumë për zemër.

— Duhet të mendoni më shumë për vajzat që i keni burgosur brenda shtëpive, — filloi e para Urania.

— Mendojmë, po kush na i vë veshin neve!...

— Kemi lindur që ta ulim kokën në jetë, — tha një grua tjetër.

— Jo, të mos ta ulim fare, po ta ngremë lart, — ndërhyri mësuesja. — Ju keni dëgjuar patjetër për trima si Çerçiz Topulli e Mihal Gramenoja me shokë. Kush i lindi dhe i edukoi ata me urrejtjen e madhe për të huajt dhe me dashurinë për Shqipërinë?... Nëna, nëna si ju i lindën dhe i rritën ata. E sa të tillë lindin e do të lindin për mëmëdhënë! Nënat lunxhote, këtu pranë jush lindën Koton, gojëbilbilin, lindën Pandelinë, Jankon...

— Kapetane je, moj Urani, s'ta ha qeni shkopin, — i thoshnin me radhë gratë nokovite, që e dëgjonin me vëmendje të madhe.

E këto biseda nisën të bëhen gjithnjë e më shpesh mbasditeve. kur gratë e vajzat e fshatit mblihdeshin tek njëra-tjetra. Për çdo familje dhe sidomos për vajzat nokovite, Urania u bë një njeri i afërt e i dashur. Shpesh, kur ajo rrinte e punonte në dhomën e saj, dëgjonte që nga prapa portës një zë gruaje të hollë, të trembur:

— Urani! Dil një çikë, kam një porosi.

Mësuesja dilte me vrap.

— Na, mos ma merr për keq. Hapëm një byrek me një dorë miell që kishim, po s'na shkante poshtë vetëm. Merre, merre!

— Po unë kam, jepuani fëmijëve, se është kohë e vështirë për bukë, — i thoshte e mallëngjyer Urania.

— Jo, jo, merre! E kemi për gaz dhe ne. Merre, se me gjithë shpirt ta japim.

Shumë shpejt mësuesja dhe edukatorja e fëmijëve u bë anëtare e çdo familjeje fshatare. Dhe ato e mbronin si ta kishin vajzën e tyre. Gratë nuk i harronin ato fjalë të hidhura që kish thënë «njeriu i zotit» i ardhur atëherë nga Mitropolia e Gjirokastrës.

— Zoti i ndjen mëkatarët e tij dhe u lë mangut ndonjë gjë, — i kishte thënë ai një mesogruaje për Uraninë¹⁾.

— Ç' thua kështu! — i qe përgjigjur ajo. — Po ti na mëson të mos shajmë, uratë. Ç' janë këto?...

— Syri im s'është te gënjeshttra, tek nata dhe padituria që duan të lënë ata tek njerëzit e thjeshtë të popullit, por tek e vërteta, tek drita dhe dituria, — u tha Urania kur e mësoi këtë sharje, që i kish bërë ai prapa krahëve. — Dhe i shkoi mendja tek mësuesit Pandeli Sotiri, Petro Nini Luarasi, tek patriotët Papa Kristo Negovani e At Stathi, që jo vetëm u ndoqën nga kisha, por edhe u zhdukën fizikisht prej Patrikanës.

Ditën e fundit të atij viti shkollor u mblodhën të gjithë, nxënës e fshatarë. Tërë vitin mësuesja u kishte mësuar fëmijëve plot vjersha, këngë e valle, krahas leximit, shkrimit e aritmetikës.

Tani erdhi radha që fëmijët t'i thoshnin para prindërve ato që kishin mësuar. Dhe ata i nisën një nga një, me sytë tek mësuesja, me mendjet tek fjalët e vargjeve të Naimit, Çajupit, Kotos dhe të mësueses së tyre. Në këngët dhe hapin e lehtë të valles ata shprehën gëzimin e sinqertë të tyre.

1) Urania kishte një këmbë të gjymtuar.

Gjer tutje Mingulit, tek maja mbi Këllëz, nxënësit e fshatarët përcollën me dashuri e keqardhje mësuesen e tyre dhe mbesën, që e shoqëronte vazhdimisht:

— Udhë e mbarë, mësuese! Të presim përsëri vitin e ardhshëm!

«... LIRISHT DO TË HYJ SHTËFIVE GJIROKASTRITE...»

Por viti i ri shkollor 1918-1919 e gjeti Uraninë në Gjirokastrë, në shkollën e përzier «De Rada» të lagjes Varosh. Gjirokastra e këtyre viteve nën pushtimin italian ishte e rënduar nga rrjeti i parisë konservatore e nga qarqet kishtarë. Mjerimi kishte zënë vend në çdo familje të popullit të thjeshtë.

Urania e filloi punën në një kohë kur ishin bërë përcapje të rëndësishme për krijimin e funksionimin e shkollave shqipe, për përhapjen e arsimit e të kulturës kombëtare, të cilat «përbënin një brumë që gatuhej në magjen e madhe të luftës për liri»¹). Hapja e shkollave shqipe në Labovë, Libohovë e gjetkë, si dhe krijimi i shoqërive e klubeve të ndryshme patriotike që kishin për qëllim bashkimin e popullit për liri, i kishin ngritur e ngjallur shumë ndjenjat kombëtare. Betimi i të gjithëve, në mitingun e shkurtit 1910: «Veçse me shkronja kombëtare në asnjë mënyrë tjetër nuk duam ta shkruajmë gjuhën amtare»²), tashmë kishte hyrë në rrugë të mbarë e po bëhej realitet. Në një situatë të tillë plot lëvizje

1) Gazeta «Zëri i Vlorës», nëntor 1972.

2) Po aty.

dhe frymë të lartë patriotike e nisi punën Urania në Gjirokastër.

Ajo u rregullua në lagjen «Varosh» në një shtëpi të thjeshtë gjirokastroite, tek nënë Kaliopi. Nënë Kaliopi kishte një vajzë, por, ja, i erdhi dhe një vajzë e dytë, vajzë nga fshati, por me kulturë dhe e zgjuar. Urania vuri në fund të dhomës ca rroba e libra që kish me vete dhe zuri bisedën me to, si të kishte dhjetë vjet që rronin bashkë. Pasi u njohën mirë, biseda mori udhë.

— Ja këtu do të flesh, Urani. Siç e sheh nuk jemi shumë në gjendje. Pa çka, kemi duart, moj vajzë e mbahemi me krahët tanë. S'kemi ndonjë ndihmë tjetër. Që kur më vdiq i shuari (e kish fjalën për burrin) ngushtë kemi shkuar, si gjithë dhe ne.

Urania i ra në shpatulla me dashuri, sikur deshi t'i shpërndante brengën që e mbuloi.

— Ti si t'a kesh punën e rehatin tënd bëj, o bijë. Nga unë e vajza ime derën e zemrën hapur i ke.

Kështu u njoh ajo me nënë Kaliopin, që do të hyjë thellë në jetën e mësueses. Nisi jeta në familjen e re. Në një dhomë të katit të dytë shumë shpejt u vendos një tavolinë e vogël, një llampë vajguri, ca libra e fletore, një karrike e zakonshme. Urania rrinte orë të tëra në atë dhomë, shkruante e lexonte pa e ngritur kokën fare. Nënë Kaliopi, që e deshi si vajzën e saj, që në fillim, e shihte në sy, i vente afër e i thoshte:

— U lodhe, moj Urani. Ke tri orë ulur mbi libra. Po thuajmë dhe mua, ç'janë gjithë këto që shkruan ti?...

— Gjëra të mira janë, të mira, — thoshte e qeshur Urania. Do të të mësoj edhe ty, nënë Kaliopi, të lexosh e të shkruash nga këto libra...

— Oh, unë s'kam asnjë gaz në jetë tani. Vetëm t'ju kem ju vajzave mirë e t'ju gëzoj... Dale, dale, mos u ul prapë, rri e çlodhe kokën njëçikë. Do të pimë një kafe bashkë, se kam ruajtur pak në fund të dollapit.

Urania tundte kokën duke buzëqeshur.

— Paç të mira e gaze, moj bijë, se je bahçe nga zemra e nga mendja, — i thoshte nënë Kaliopi.

Pinin kafënë dhe bënin bisedë si nëna me bijën. Urania e mbajti mend tërë jetën shërbimin që i bëri asaj nënë Kaliopi, kur u sëmur rëndë nga tifoja.

Shkolla ishte afër shtëpisë ku banonte. Por, të qëndruarit në lagjen «Varosh» i dha mundësi Uranisë ta njihte nga afër jetën e familjeve gjirokastrite. Puna prej dy vjetësh në fshatrat e Lunxhërisë e njohu mirë me fatin e vajzave asokohe. Në qytet mjaftoi një kohë e shkurtër ta njohë edhe më mirë këtë jetë. Gratë gjirokastrite nuk e kishin hequr perçen e ferexhenë e zezë nga fytyra dhe as mund të dilnin përjashta vetëm ose të guxonin të shihnin nga kafazet e dritareve në praninë e burrave. Zakonet e egra të feudoborgjezisë të kohës e detyronin gruan të rrinte brenda katër mureve të shtëpisë, brenda natës dhe errësirës, midis injorancës e paditurisë. Dhe shtypi reaksionar i kohës e përkrahte këtë gjë dhe e përforconte me fjalë dhe propagandë të tillë:

«Shqipëria s'mbahet me të rrenuarit e nderit dhe zbulimi i grave nuk bie përparimin, po çnderimin...»¹⁾. Me të tilla mënyra të ulëta ata kërkonin

1) «Gjirokastra në shekuj». (Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë, dorëshkrim.)

të largonin sa të qe e mundur çdo mendim e përpjekje për çlirimin e gruas.

Por mbi propagandën e shpifjet e tyre u ngrit i fortë zëri dhe puna e Urani Rumbos. Luftën kundër ferexhesë ajo e nisi që në lagje me fqinjët e saj. I shihte gratë shpeshherë tek dilnin të mbuluara dhe një ditë u foli hapur si motër, si shoqe:

— Mos dilni me ferexhe, moj motra. Pse e mbulononi fytyrën kështu? Nuk e ruan ndershmërinë kjo copë leckë, — dhe u mat t'ua hiqte.

— Jo, jo, nuk e heqim. Është zakon i vjetër shqiptar, është shenjë e ndershmërisë, — tha tërë frikë njëra prej tyre.

— Nuk është zakon shqiptar ky, jo, por na e ka lënë i huaji. Pse ne nga Lunxhëria e më tutje, Labëria, që s'mbajmë ferexhe, mos vallë nuk jemi shqiptarka, apo nuk jemi të ndershme?... Hë, si thoni ju?...

Vajzat u ndodhën ngushtë nga fjalët e Uranisë dhe shikuan njëra-tjetrën.

— Dhe ne shqiptarka jemi dhe madje shumë të ndershme. Por këtë zakon të prapë e solli i huaji. Ai deshi të na ndajë nga jeta e nga drita ne grave e vajzave, që ta shohim botën jo drejtpërdrejt me sytë tanë, por poshtë çarçafit e ferexhesë së zezë.

— Po ta heqim, do të na ndjekë syri dhe llafet e botës, — u përgjigjën vajzat të menduara.

— Por ne duhet të ngrihemi mbi fjalët e tyre, — përfundoi Urania.

Në ditët që erdhën më pas, kjo bisedë u hap përsëri. Një pjesë e grave dhe e vajzave të lagjes «Varosh» ecën me guxim pas fjalës së mësueses. Ato e fiakën tutje ferexhenë, për të mos e veshur kurrrë më.

Viti që Urania punoi si mësuese në shkollën

«De Rada» i dha mundësi të njohë nga afër gjendjen e rëndë të gruas gjirokastrite. Ishte pikërisht në këtë vit që Uranisë iu forcua bindja se duhej hapur një shkollë femërore. Qëllimi i saj ishte që të shpëronte vajzën e mbyllur brenda shtëpisë që në moshën 9-10 vjeçe; ajo donte edhe të shkëpuste vajzat e familjeve me gjendje të mirë nga edukata e disa mësuesve privatë, mësimet e të cilëve kishin një frymë antikombëtare, e t'u mësonte vajzave gjuhën e bukur amtare. Por qëllimi i saj më i lartë ishte që të shkollonte vajzat e familjeve të varfra që nuk kishin mundësi ekonomike, të arrinte të afronte e të bashkonte myslimane e të krishtera duke u dalë kështu ballë për ballë qëllimeve armiqësore të shovinistëve e të mitropolisë.

Shkolla femërore, që u krijua kryesisht me punën dhe përpjekjen e palodhur të Urani Rumbos, *shkolla femërore* duke pasur kudo e kurdoherë ndihmën morale e materiale të popullit arsimdashës gjirokastrit, mbledhi në gjirin e saj qysh në fillim dhjetëra vajza. Urania, me vullnetin dhe kurajon e saj të patundur, hynte në çdo shtëpi, në çdo lagje dhe, me fjalën e saj të mençur, i bindte prindërit për të tërhequr nxënëset në shkollë. Kur e nisi punën në shkollën femërore, ajo ndjeu një kënaqësi të papërshkruar që shkolla mori emrin e Koto Hoxhit, të këtij mësuesi patriot, punën e të cilit ajo e pati gjithnjë parasysh në rrugën e saj fisnike. Kjo kënaqësi duket qartë në kujtimet e vetë Uranisë kur thotë:

«...Kur shkela pragun e kësaj shkolle, më mbërtheu një dashuri akoma më e madhe për mësuesin gestoratas që, tok me të tjerë, botoi alfabetaren në Stamboll. Me anën e shkollës që mban emrin e «Koto Hoxhit», do të hyj lirisht në shtëpitë e Gjirokas-

trës, duke marrë vajzat brenda saj, për t'i dërguar pastaj si edukatore e mësuese në qytet e në fshat...»¹⁾

Urania filloi tani të hyjë lirshëm nëpër shtëpitë gjirokastrite.

Sa mbaronte mësimin, ajo hidhej portë më portë: në «Hazmurat» e «Çetemel», në «Palorto» e «Varosh», në «Dunavat» e «Manalat», për t'i marrë vajzat në atë shkollë ku shumë vjet më parë, patrioti Panajot Dhimua, u përpoq që edhe «vajzat të bëhen pjesëtare të së mirave të arsimit e të kulturës»²⁾, të cilit poeti popullor do t'i këndojë me dashuri:

«...Ai na nderoi vendë,
Na bëri skoli t'argjendë,
Vajzat na u bënë djem,
Se na mësuan kalem...»

Këtë punë nëpër tërë lagjet e qytetit ajo e nisi në vitet 1919-1920 në shkollën femërore, dhe nuk do të heqë dorë prej saj sa kohë që vazhdoi të ishte mësuese aty.

Vitet e para ajo e pati shumë të vështirë me prindërit e vajzave.

— E dërgoj vajzën në shkollë, moj mësuese, por nuk dua të më rrijë tok e trazuar me kaurkat ose myslimankat... — i thoshnin prindërit.

— Nuk ka asnjë gjë të keqe këtu, moj nëna të mira, — u fliste me takt e butësi Urania. — Por, ja... thuajmë, ç'ndryshim kini ju me mua, që jemi në fe të ndryshme?...

— Ti, jo, jo!... Mos e merr kështu, s'themi për ty ne, por të tjerat janë...

¹⁾ «Gjirokastra në shekuj».

²⁾ Arsimi popullor Nr. 12 (1956).

— Janë motrat tuaja, jemi të gjithë shqipëtarë,
— i ndërpriste Urania. — Kemi një qëllim të përbashkët; të rrisim e të edukojmë vajza të ditura e me kulturë, ja ç'jemi të tërë.

Kjo luftë që me të vërtetë shumë e vështirë. Me këmbëngulje të fortë Urania arriti suksese në kapërcimin e dasisë fetare në radhët e qytetarëve si dhe të thyejë ato ndjenja të ngushta të lokalizmit të theksuar midis lagjeve. Dhe suksesi që arriti ia mbushi zemrën me gëzim, siç e pohon edhe vetë: «Gëzimi im më i madh si mësuese në shkollën femërore ishte se vendosa në një bangë e krah më krah vajzën myslimane të «Manalatit» me atë (të krishterën) të «Varoshit», si motra të pandara nga njëra-tjetra...»¹⁾

Gjithë përpjekjet e saj në shkollën femërore, patjetër ishin të inkuadruara e zhvilloheshin në sfondin e përpjekjeve të mëdha të të gjithë patriotëve të vendit, të të gjitha ngjarjeve historike e shoqërore, që ndiqnin jetën në Shqipëri. Këtyre ngjarjeve historike Urania nuk i qëndroi larg, as në krah, por hyri mes për mes tyre, i jetoi, i ndihmoi duke drejtuar punën në shkollën e saj.

Kështu, pas Konferencës së Pages të Parisit (dhjetor 1919 — janar 1920) ku u vendos copëtimi i Shqipërisë, lëvizjet patriotike u rritën e u forcuan. Pjellë e këtij vrull patriotik të popullit shqiptar ishte edhe Kongresi i Lushnjës, ku pjesëmarrësit u betuan se do ta ruanin në çdo kohë pavarësinë e plotë të Shqipërisë, bashkë me popullin që «ishte gati për çdo therori»²⁾. Vendimet e këtij kongresi, që kishin për

1) Arsimi popullor Nr. 4, viti 1964.

2) Historia e Shqipërisë.

qëllim mobilizimin e popullit shqiptar dhe bashkimin e tij në luftë të vendosur për të fituar pavarësinë e për të mbrojtur tërësinë tokësore të vendit, si dhe luftërat e Vlorës në vitet 1920, u bënë të njohura nëpërmjet shtypit lokal. Urania, që ishte bashkëpunëtorë e rregullt e organeve të shtypit lokal, i diskutoi me zjarr këto lajme të rëndësishme me nxënëset e saj. Me entuziazëm e priti ajo, si gjithë populli gjirokastrit, 22 korrikun e vitit 1920, ku gëzimi i çlirimit të Vlorës u shpreh me një festë të madhe e miting nëpër rrugët e qytetit. Epopenë e 1920 ajo e jetoi plotësisht.

Pas këtyre ngjarjeve të rëndësishme, që ndikuan shumë në formimin e saj patriotik, vitet 1921-1924, që ishin vite të lëvizjeve të mëdha demokratike, e gjetën Uraninë në radhën e intelektualëve demokratë, të cilët filluan të ngrenë një varg shoqërisht kulturor-arsimorë. Një nga problemet themelore të zhvillimit kulturor të vendit ishte ai i arsimit. Prandaj arsimitarët patriotë, midis të cilëve edhe Urani Rumboja, iu përveshën punës për organizimin e arsimit mbi baza kombëtare dhe demokratike.

Në këtë periudhë mori një hov të madh edhe lëvizja e grave shqiptare. Në krye të kësaj lëvizjeje, që kish qëllim çlirimin e gruas dhe aktivizimin e saj në jetën shoqërore të vendit, në Gjirokastrë u vu Urania me shoqe.

Ashtu sikurse shumë patriotë të tjerë, Revolucionin Demokratiko-Borgjez të Qershorit 1920 e përkrahu edhe Urania. Për këtë flet në kujtimet e saj një kolege e Uranisë¹⁾. Ato thonë se Urani Rumboja bashkë me shokë të tjerë u bënë gati të nise-

1) Kujtojnë Hasibe Hashorva e Naxhije Hoxha.

1920:
Lufta e Vlorës

shin për në kufijtë e Jugut, me çantën e Kryqit të Kuq në krah. Qëllimi i tyre ishte të ndihmonin patriotët e plagosur që luftonin kundër reaksionit feudal, që mbështetesh nga qeveritë shoviniste, të vendeve fqinje.

Krahas aktivitetit të saj politik e shoqëror, që sa vinte zgjerohej, ajo nuk e ndërpreu për asnjë çast punën e madhe që iu desh të bënte në shkollën e saj. Shkolla femërore ku ajo jepte mësim ishte në një gjendje të vajtueshme nga ana materiale, ashtu si dhe e shumë shkollave të tjera të rrethit, ashtu si gjithë gjendja ekonomike e vendit tonë në këto vjetë të vështirë. Në shkollë mungonin fletoret e librat, që ishin mjetet kryesore të mësimit, duke mos përmendur pastaj të tjerat. Por me luftën e paprerë të saj, të kolegëve, të grave gjirokastrite e të gjithë elementëve përparimtarë të kohës, këto vështirësi po kapërceheshin.

Prirja e saj letrare, studimi i vazhdueshëm i traditës së letërsisë sonë dhe i letërsisë përparimtare botërore, i dhanë mundësinë e një njohjeje më të thellë të fenomeneve shoqërore dhe të rrjedhshmërisë së fjalës, gjë që i shërbeu mjaft në punën e saj si edukatore e brezit të ri. Problemin e shkollës ajo e bëri sa mundi problem të të gjitha familjeve arsimdashëse gjirokastrite. Në ato vite do ta shihje shpesh Uraninë nëpër kalldrëmet e lagjeve të Gjirokastres. Sa herë që i mungonte ndonjë fëmijë nga klasa, ajo do të linte çdo punë e do të shkonte tek familja e fëmijës që kishte munguar.

«— Ishte pak e sëmurë, — justifikohet kot prindi që ndiente ndrojtjen e fajësisë kur shihte mësuesen që i vinte në shtëpi.

— Nuk duhet të mungojnë kot, nëne. Vandin

më të rëndësishëm, shkollën, më të shenjtë se kishën e xhaminë, të mos e merini për ndonjë vend lodrash»¹⁾, — u thoshte Urania.

«— Një ditë ishte kjo e sotmja, pa do të vijnë e do të mësojnë.

— Ju duhet të kujdeseni më shumë për arsimin e vajzave. Ju kujtojmë se ju jeni edukatorët e parë të fëmijës suaj dhe keni një barrë e një detyrë të madhe kundrejt shoqërisë së ardhme të Atdheut, që pret e shpreson shumë nga mëmat e pritme, që do të japë brezi që po rritet»²⁾.

Prindërit i dëgjonin fjalët e saj me vëmendje e mendoheshin gjatë për ato që thoshte ajo. Fjalët e saj kishin me vete të vërtetën e madhe dhe ish e pamundur të mos bashkoheshe me mendimin e saj.

«— Të punojmë, për të ndrituar mendjen e «shukuruar», moralin e kësaj vajzërie, nga të cilat ushqehen shpresat e ëndrrat ideale të kombit tonë»³⁾, — u thoshte Urania.

«Kur ishte puna për probleme të shkollës, Urania i zinte prindërit në rrugë, në punë, në dasma, në vaje, kudo që të ishin, dhe me fjalën e saj mundohesh të thyepte mendime e koncepte. Ajo, tamam si të ishte një burrë i fortë, i shtronte problemet e kërkesat e shkollës përpara parisë e qeverisë së qytetit dhe i ndiqte gjer në zgjidhjen e tyre të mundshme»⁴⁾.

Duke qenë bashkëpunëtore e gazetës «Drita», vitin e dytë të shkollës femërore 1920-1921, Urania

1) Gazeta «Drita», 20 maj 1921.

2) Po aty.

3) Po aty.

4) Nga Naxhije e Nedret Hoxha (gojarisht).

nisi ta shprehë hapur e vazhdimisht mendimin e saj, në çdo shkrim të saj, për detyrën e çdo prindi gjirokastrit: «Shqipëria, e rilindur me kaq therorira të protagonistëve të lirisë së saj, ka nevoja të mëdha. Shpreson ta nxjerrë faqebardhë brezi që po ngrihet, i kësaj vajzërie dhe djalërie... Faktorët e parë të realizimit të kësaj shprese do të jenë pa fjalë vullneti dhe patriotizmi juaj për mbarëvajtjen e arsimit dhe të shkollës. Pra keni detyrë të na ndihmoni pa u kursyer në udhëtimin tonë të vështirë për arritjen e këtij ideali...»¹).

Ja se si shkruan ajo në gazetën «Drita» të datës 27 gusht 1920 për çeljen e shkollës shqipe në fshatin Stegopul: «Është gjynah që këtij fshati, që e flet kaq bukur shqipen, me pesëdhjetë çuna, të mos i jepet një mësues nga qeveria...»

Kjo rrugë e këto mendime të shprehura hapur e çiltas bënë që Urania të ketë në krah e në të njëjtin front pune e përpjekjeje një masë të madhe nënash e grash gjirokastrite. Në saje të ndihmës e të përkrahjes së tyre ajo do ta hedhë hapin me vendosmëri, duke parë me guxim të ardhmen. Janë këto gra që i ndihmoi dhe i rriti Urania dhe në të njëjtën kohë e ndihmuan dhe e rritën Uraninë.

Shkolla femërore nuk e kishte syrin vetëm në të mësuarit formal të gjuhës shqipe, pra në të shkruarit e në të folurit e saj. Ky ishte një kuptim i cekët i fjalës. «Shkollë nuk domethënë godina e as të 36 shkronjat e abetares, që janë mjet e jo kurrë qëllim. Shkollë do të thotë edukim i shpirtit dhe arsimit i mendjes...»²), shkruante ajo. Pra ajo me kolegët e saj përpiqej që të mësuarit të mos mbetej një proces i

1 Gazeta «Drita», 20 maj 1921.

1) Gazeta «Drita», 20 maj 1921.

njëanshëm i përvetësimit të dijeve nga ana e nxënësve. Urania me shoqe mundohej që arsimimi i fëmijëve të vlente që këto dije që mësonin në shkollë ato të ishin të aftë t'i praktikonin në jetë, për të mirën dhe begatinë e vendit të tyre.

Ishte bërë zakon në shkollën femërore të bëheshin shpesh ekskursionet të lira dhe mësimore. Nxënësit, atë çka mësonin në klasë, e praktikonin edhe në natyrë. Ato përgatiteshin me kujdes nga mësueset me një tematikë të pasur dhe edukative. Sidomos ekskursionet e majit nxënësit nuk i harronin.

Ishte 1 maji i vitit 1921 kur shkolla vendosi të bëjë një ekskursion. Gjithë nxënëset u lajmëruan të mirrnin me vete librat e, atje, në natyrë, do të praktikonin më mirë mësimet e diturisë së natyrës. Ato e pritën me gëzim të madh lajmërimin. Po ky gëzim që i shkurtër.

— Nesër kemi shëtitje me shkollën, do të marrim edhe librat — u thanë me entuziazëm vajzat prindërve të tyre.

— Shëtitje?... Jo, jo. S'na duhen shëtitjet. Ka punë plot shtëpia, — thanë prindërit e vajzave.

Mëngjesin e 1 majit ora vajti dhe kaloi, po nxënëset nuk po vinin. Ekskursionin dështoi.

«Gjithë atë ditë — kujton një kolege e Uranisë, kemi vajtur me Uraninë në shumë shtëpi. E nisëm nga «Varoshi», që e kishim më pranë shkollës, e dolëm në «Palorto». Urania nuk lodhej duke u folur nënave të vajzave për rëndësinë e atij ekskursionit që nuk ishte kryer».

Më 4 maj u bë një mbledhje e madhe në shkollën femërore për këtë problem. Duhet mposhtur ky koncept i prindërve, duheshin ndihmuar ata. Dhe këtë do ta bënte shkolla. Deri në javën e parë të

majit u kalua në të tëra shtëpitë e nxënësve, u bisedua me shumë prindër. Më datën 20 maj, me anë të një shkrimi të thjeshtë e dashamirës në gazetën «Drita», Urania, në emër të gjithë mësuesve, u drejtohej prindërve:

«Ndieni detyrat tuaja të larta përballë fëmijërisë. Prindër, këtij brumi të shenjtë që do të ngjitet sipas qëndrimit tuaj më parë, e pastaj nga shkolla, nga e cila e ndaloni për shkaqe fare të parsyeshme...»¹⁾

Në mendjen e nxënësve hynë më vonë shumë shetitje të bukura, ndryshe nga ajo e vitit 1921. Më pas, ditët që kishin ekskursione, nxënëset visheshin bukur e pastër dhe dilnin nga Teqja e Baba Manes, nga sheshet e bukura të Kordhocës e të Ura e Lumit. Një vajzë e vishnin me rroba të çelura dhe e mbulonin me kurora lulesh. Rreth vajzës me lule, që simbolizonte Shqipërinë e lirë, të qeshur, të lulëzuar, që do të vinte, nxënëset hidhnin valle e thoshnin këngët e vjershat e mësuar ose të krijuara nga vetë mësuesja e tyre:

*«... Mirëse erdhe një maji plot gëzim
Përpara vajzërisë (refren),
Të presim gjithë lule e gjelbërim.
Vajza e djem së bashku të këndojmë,
Çerdhe plot dashuri, patjetër, do
ndërtojmë...»*

1) Gazeta «Drita», 20 maj 1921.

SHOQE E MOTËR PËR TË GJITHË

Verat e viteve 1918-1919-1921 janë të lidhura me kurset e para pedagogjike të zonës së Jugut. Në këto kurse, midis mësuesve me përvojë më të madhe si Thoma Papapano, Hysni Babameto, Sevo Pesha e të tjerë ishte edhe e vetmja femër, Urania Rumboja. «Në fillim erdhi e ndrojtur dhe e heshtur — tregon Thoma Papapanoja për të. — Dëgjonte me vëmendje të madhe ç'thuheshin dhe mbante shumë shënime. Ndërhynte rrallë dhe më tepër kur ishte fjala për arsimin femëror. Por më vonë u bë drejtuese në kurs për mësimin e këngës. Ku i kish thënë ato këngë! Ca nga Lunxhëria, ca të bëra vetë, këngë plot mendim dhe me domethënie të madhe. Nga Urania kursistët mësuan këngët:

Lomtimin e Mbe... shëndet,
«...Kij shëndet, e mjera botë,
Kij shëndet, e mjera jetë,
Kini shëndet, ju kronje, brigje, male e
hone...»

e përkthyer dhe e përshtatur prej saj, e që evokonte heroizmin e grave shqiptare të Sulit».

Bashkë me zërin e gjithë kursistëve ishte dhe

Është këngë për shëndetin

zëri i vetëm femëror i Uranisë. Kur u bë një debat me një mësues italian të kursit:

— Nuk dihet nëse Skënderbeu është shqiptar apo sllav — lëshoi në gjuhën e vet, në një orë mësimi, një mësues italian i kursit.

Akoma pa mbaruar mirë fjalën, klasa ushtoi. Me revoltë e ironi folën njëherësh mësuesit shqiptarë:

— Mos kërkoni ta nxirrni edhe Skënderbeun italian ju?... Por jo, ore, jo. Trima si Skënderbeu lind vetëm Shqipëria, ndaj ai ishte shqiptar. Mos e vrisni kokën ta nxirrni ndryshe, se s'del tjetër, veç shqiptar.

Duhet thënë se në vitet 1916-1920 italianët hiqeshin si dashamirës për çeljen e shkollave dhe mësimin e gjuhës shqipe në to, por praktika tregoi se ata u përpoqën të përhapnin gjuhën e tyre, ashtu sikurse deshë të bëjë çdo pushtues. Por në qoftë se s'u mësua asnjëherë gjuha e huaj përpara gjuhës sonë amtare, në qoftë se nxënësit e dikurshëm nuk mbajnë mend as emrat e mësuesve të huaj, kjo është për punën dhe meritën e mësuesve shqiptarë. Urani Rumboja u shqua për këtë si edhe në përpjekjet për t'u mësuar nxënëseve një shqipe të pastër e pa barbarizma. Sa herë i dëgjonte nxënëset ose prindërit e tyre të thoshnin «lepe», kur u flistë njeri, Urania menjëherë ndërhynte:

— Të mos dëgjoj më të përgjigjeni me këtë fjalë. Ne kemi fjalën tonë shqipe «urdhëro». Dëgjojeni sa bukur që tingëllon! Ç'na duhen fjalët e të huajit?

— E kemi të vështirë ta heqim tani, se e kemi mësuar e folur shumë herë, moj Urani.

— Por nuk e kemi aspak të vështirë të mbajmë

gjuhën tonë amtare, prandaj do të themi «urdhëro».

Këtë punë e bënte kudo që të ishte. Sa herë i kapte veshi fjalë të huaja ajo ndërhynte. Edhe në fshatrat e Lunxhërisë, ku jetoi e punoi, shumë herë u fliste fshatarëve të mos i përdornin fjalët e huaja: kalimera, selamaleqem, lipon etj., por fjalët e gjuhës sonë «që ka hije, porsi hëna në mes yje» — siç thoshte mësuesi patriot Koto Hoxhi.

Gjithçka që mësonte në kurset si dhe nga literatura pedagogjike përparimtare e kohës, për të cilën ajo qe kurdoherë e informuar, sepse lexonte shumë, Urania e sillte në shkollën e saj. Ajo i mësoi dhe i nxori vetë mësueset e ardhshme të shkollës femërore Hasibe Hashorvën, Naxhije Hoxhën, Xhemile Bilalin e më vonë Nebahet Bakirin, që, siç thotë për to shoku Enver Hoxha: «...në kohë të vështira, mësonin motrat e tyre, që aktualisht janë gjyshet ose nënat e të rinjve të sotëm të Gjirokastrës»¹).

Hasibeja ishte në klasën e pestë, në vitin shkollor 1920-1921, kur Urania u bëri një hartim në klasë, për traditën e trimërisë shqiptare. Hartimi i saj u lexua në klasë, ishte më i miri. Kur mbaroi ora, nxënëse e mësuese bënë një bisedë që s'e kishin bërë asnjëherë.

— Hasibe, ti je nxënëse shumë e mirë, e zonja, a ke dëshirë të bëhesh mësuese si unë?... — e pyeti Urania.

Në sytë e nxënëses së saj, që u skuq e mblodhi supet, u duk një çudi e madhe, aq sa s'dinte të jepte përgjigje, veçse tha fjalë pa lidhje:

— Po unë, ...ku di unë... — Dhe vazhdoi t'i dukej tepër e çuditshme dhe e vështirë ta përfyty-

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1972-1973» f 431.

ronte veten të bëhej si mësuesja e saj, që e admironte aq shumë.

— Është e vështirë, por jo e paarrirë... — i tha Urania, që e kuptoi hutimin e saj. — Unë do të të ndihmoj shumë. Dhe i ra në shpatulla me dashuri.

— Por kjo s'varet vetëm nga unë, mësuese, — shtoi me frikë nxënësja. — Ç'do të thonë në shtëpi?...

— Ti si më thua njëherë, ke dëshirë vetë? — pyeti prerë mësuesja.

— Oh,... sikur të mundja!...

— Mirë, mirë. Sot do të vij vetë nga shtëpia.

Si gjithë vajzat që mbaronin shkollën edhe Hasibenë e prisnin katër muret e shtëpisë, ferexheja, paja. Por Urania nuk e la. Ajo vajti disa herë në shtëpinë e Hashorvatëve. Dhe ia arriti qëllimit të saj fisnik. Në vitin shkollor 1921-1922 nxënësja e Uranisë, Hasibeja, nisi punën si mësuese e klasës së parë të shkollës femërore. Një javë para se të fillonte shkolla, Urania u muar vetëm me mësuesen e re. Me dashuri dhe vëmendje ajo ia përgatiti vetë gjithçka. Me dorëshkrimet e Uranisë jepeshin shpesh në shkollë aritmetika, gjuha, dituria e natyrës, se libra s'kishte gjithmonë.

«Më ka dashur e më ka ndihmuar shumë Urania — kujton sot Hasibeja. — Në fillim vajta në shkollë si mësuese me një ndrojtje të madhe dhe e mbuluar me ferexhe, por ajo m'i hoqi shpejt që të dyja. Më jepte vetë mësimet të veçanta. Duke qenë vetë mësuese, unë përfundova njëkohësisht edhe klasën e gjashtë atëherë. Dhashë disa provime dhe mora një dëftesë plotore. Që unë u bëra mësuese, kjo i takon ndihmës dhe këmbënguljes së Uranisë. Megjithëse isha e re në moshë, ajo më trajtoi si shoqe dhe së bashku kaluam si motra të mira deri në fund. As

unë dhe as shoqet e tjera nuk u ndamë asnjëherë nga fjala dhe rruga e Uranisë, sido që qenë kohë të vështira...»

Për të krijuar mundësinë e një arsimimi më të gjerë të vajzave, në vitin 1921 Urani Rumboja bashkë me kolegët e saj kërkoi që të shtohet edhe një rend tjetër në shkollën femërore. Për këtë çështje ajo me të drejtë, që më 18 qershor 1921, në gazetën «Drita» shkruan: «Shtimi i një rendi në shkollën femërore do të ndihmojë tepër në modernizimin e efekteve shkatërruese të një zakoni tonë të keq: Nxënësja, si të mbarojë rendin e fundit të shkollës, duhet të mbyllet në «bastijet»¹⁾ gjirokastrite dhe të shburgoset në kohën e martesës... Por shtimi vit me vit të një rendi do ta shporrë dalngadalë idenë e shtrembër të mosdaljes së gruas...»

Vitet që pasuan në këtë shkollë kishin jo më pesë por gjashtë klasa. Vajzat dilnin nga shkolla në një moshë më të rritur dhe më të pregatitura për jetën.

«Sa mbarova gjashtë vjet të shkollës femërore me mësuese Uraninë, mendova se shkolla për mua kaq ishte. S'ishim dhe në gjendje ekonomike dhe as që mendoja më për shkollë — kujton një ish-nxënëse e saj. Por Urania erdhi shumë herë në shtëpinë tonë dhe bisedoi me babanë, që të më dërgonte në shkollën e mesme femërore në Korçë. Kur do të nisesha më porositi:

— Tani duhet të mësosh shumë, je vajzë gjirokastrite, e aneve dhe e nanave të forta, copëz e kalasë së Argjiros.

E putha me dashurinë e madhe të nënës, të mo-

1) e ka fjalën për muret e shtëpisë.

trës e të shoqes. Pastaj, pa kuptuar, më hodhi disa të holla në xhep:

— Merri, do të të duhen — më tha me ngadalë.

Nuk do ta harroj kurrë taktin e saj të rrallë kur e bëri këtë veprim. Ajo i donte dhe i përkrahte shumë të varfrit...»

«Kishte një korrektësi të rrallë e një shkrim të shkëlqyer Urania, — na thotë nxënësja e saj, Nedret Hoxha. — Ajo nuk lodhej t'i korrigjonte detyrat me shkrim e hartimet, hollësisht dhe disa herë, gjersa ne të arrinim t'i bënim fare pa gabime. Sot më vlerësojnë mua për korrektësi e shkrim të bukur në punën time. Por kjo është thjeshtësisht pasqyrë e punës së mësueses, edukatë e saj tek unë, ish-nxënësja e saj...»

«...Veç shetitjeve që na bënte shpesh brenda qytetit, — thotë një ish-nxënëse tjetër e saj, — ajo na bënte dhe ekskursione jashtë. Në një prag pranvere mësuesja na lajmëroi:

— Do të bëjmë një shetitje në qytetin bregdetar, Sarandë. Besoj se të gjitha keni dëshirë ta njihni këtë qytet shumë të bukur.

Thuajse të gjitha e miratuam. Unë nuk fola, jo se nuk doja, më pëlqente shumë, por nuk kisha guxim të kërkoja të holla në shtëpi. E shihja vetë, ishim shumë ngushtë ekonomikisht. Një ditë para se të niseshim më porositi:

— Nesër bëhu gati për shetitje...»

Unë ula kokën dhe nuk thashë asnjë fjalë. Mësuesja jo vetëm që i vuri vetë tërë shpenzimet e rrugës, por më mbajti shumë afër tërë ditën. Ai ishte një ekskursion i shkëlqyer për mua...»

Kujtimet e nxënësve për të janë të shumta, të ndryshme. Nga fjala e tyre është lehtë të krijosh

bindjen për një mësuese shumë të mirë, për një motër të dashur, për një shoqe të shkëlqyer.

Urania u bë drejtoreshë e shkollës femërore dhe kurdoherë që ndihmëse e mësueseve të reja në këtë shkollë: E Naxhijes, Hasibesë, Xhemilesë, që nuk e kishin arsimin përkatës.

Çdo verë, pas një pushimi të shkurtër në Bari të Italisë, ku bënte vazhdimisht kura, sepse vuante nga koliti, ajo bënte dhe një punë të madhe, në ndihmë të ngritjes pedagogjike të mësueseve të reja. Me iniciativën e saj, Urania organizonte kurse brenda shkollës për aftësimin e tyre metodik. Aq praktike i bënte këto kurse, sa që ato i ndiqnin vullnetarisht edhe mësues nga shkolla të tjera.

Gjatë kohës kur ishte drejtoreshë e shkollës, Urania realizoi me një takt të përsosur kontrollet e ndihmës metodiko-edukative si dhe orët model.

«Kishte klasën e katërt atë vit Urania, kur organizoi një orë model në lexim, — kujtojnë sot gjithë ish-koleget e saj. — Doli një orë e mbaruar. E qetë, e sigurt në fjalën që thoshte, ajo ishte mjaft e përgatitur, me një material interesant dhe me një metodikë të shkëlqyer. Ajo e vërtiste fjalën aq mirë, sa dhe ne u bëmë plotësisht, si dikur, nxënës të saj. Kjo ishte një orë e zakonshme për Uraninë...»

Pas fjalës, ndihmës, shembullit të saj ecën koleget e reja dhe gjithmonë me to, mes tyre, eci dhe Urania.

Ajo pati rezultate shumë të mira në shkollën femërore të Gjirokastrës, sepse diti të kombinojë punën nxënës-mësues-familje. Nxënësja e vështirë në këtë shkollë ishte problem për tërë personelin arsimor.

— Sot e ke shkruar detyrën që dhamë dje? —


Shprehja e dashurisë

Ganimet Ciu

Është një fletë e imbitit i cili kaq prej së "Dramës Rustonane."
Kohëzgjatja e shprehjes prej nxënës së bl. D. E.
Fund e vitit 1915-26

Ganimet Ciu

Urim i Urani Rumbos, dërguar nxënës së saj Ganimet Ciu,
pas shfaqjes së dramës «Theroria e Ifijenisë».



Urani Rumbo me grupin teatral të shkollës femërore të Gjiron-
kastrës, që shfaqti «Theroria e Ifijenisë».
Viti shkollor 1925-26.

pyeti Urania një nxënësen e saj të rritur nga shtati.

Nxënësja s'foli fare, por e pa gjatë e pa kup-tim në sy.

— Po t'i kishe bërë detyrat, do të thoshja diçka më të bukur sot, por ti...

Nxënësja filloi ta shohë më e lirë, me shikim të butë.

— Po unë përsëri do të tregoj gjëra të reja sot, të të zbukuroj mendjen, të të hap syrin.

Dhe zinte u fliste vajzave për jetën e zezë të gruas. Diku e ngrinte zërin lart e me krenari thoshte:

«Por kanë dalë gra të mençura, trime e punë-tore si Olimbia, mëma e Aleksandrit të Madh; Teuta trime, që i priti me krenari të madhërishtme amba-sadorët e Romës, kur mbretëronte në Gegëri; Voj-sava, mëma e Gjergj Kastriotit; Argjiroja jonë le-gjendare. Prej mëmave shqiptare kanë lindur he-ronj si Pirroja, Aleksandër Mollosi, Gjergj Kastrioti, Samiu, Abdyli e Naim Frashëri, Koto Hoxhi¹⁾...

Ju të gjitha duhet të bëhemi luftëtare të zonja të përparimit, të përmirësimit të jetës sonë...»

Me të tilla biseda Urania e tërhoqi edhe vë-mendjen e asaj nxënëses kokëfortë.

Në mbasdite, bashkë me Naxhijen e Xhemilenë, vajtën tek shtëpia e kësaj nxënëseje të vështirë.

— Ku mëson? — e pyeti mësuesja. — Ku e ke lavolinën, librat?...

Nxënësja tregoi me gisht një copë të dhomës dhe 2-3 libra të vendosura aty pa kujdes.

— Po mirë, ku hani bukë ju, që nuk po shoh lavolinë këtu rreth e rrotull?...

— Tani, — ndërhyri nëna, që kish ndjekur gjith-

1) Gazeta «Labëria», 29 qershor 1925.

çka pa folur vetë, — shtrojmë mësallën në shesh dhe mbliidhem rreth e rrotull.

Urania niste atëherë e u fliste gjatë për administrimin e mirë të familjes: «Shit një qilim të she-shit dhe blej një tryezë... Kjo ishte fjala e saj e prerë, pas fjalës: «Shit kalin, mëso djalin, vajzën». Këto thoshte lagje më lagje e shtëpi më shtëpi që hynte.

Pas disa kohe nxënësja e prapambetur e hodhi hapin bashkë me shoqet e tjera.

Edhe në mësim Urania ishte kurdoherë për kon-kretizimin e orës së mësimi dhe për rritjen e bazës materiale të shkollës. Ajo kishte nisur punën për ngritjen e një biblioteke.

«Sa herë shkonim tek nënë Kaliopi, se Urania na ftonte shpesh t'i shkonim e të merrnim libra, — kujton Naxhija, — shihnim se biblioteka e saj personale rritej për ditë. S'kishte libër që dilte dhe të mos e merrte e ta lexonte Urania. Edhe gjatë ve-rës, — kur shkante në Itali ose në Korfuz për hall shëndetësor, kur kthehej, sillte me vete libra të reja...»

RRETHET JASHTESHKOLLORE

Do të ishte e paplotë dhe gjysmake puna në shkollën femërore dhe arsimimi i vajzave, në qoftë se s'do t'i jepej rëndësi të mësuarit praktik të nxënësve. Sa e rëndë do të ishte që këto mëma të ardhshme, këto vajza 13-14-vjeçare, që dilnin nga shkolla të ishin të papregatitura për punët e shtëpisë. Pa dyshim, fanatikët do të gjenin shkak që të akuzonin për këtë shkollën dhe mësueset e tyre. Kurse ato, mbledhur në kësollë¹⁾ e dasmëra do të merreshin me thethaçë²⁾, në vend që të bënin biseda për mënyrën si të mirëmbajnë shtëpitë e tyre³⁾.

Sot, nxënëset e kësaj shkolle i mbajnë mend mirë orët plot interes të ekonomisë shtëpiake. Domosdo, gjuha e leximi u hapte sytë, u mësonte mirëpërdorimin e gjuhës amtare, të cilën e mbajtën të gjallë e të paprekur të parët tanë. Nëpërmjet historisë nxënëset mësonin luftërat dhe përpjekjet e pa-

1) mort (dialektore).

2) Kështu përdorej fjala «thashetheme» atëherë në popull e në shtyp.

3) Gazeta «Demokracia», 14 gusht 1926.

prera të popullit për liri e pavarësi, aritmetika, nga ana tjetër, u stërviste mendjen, por edhe ekonomia shtëpiake i përgatiste në një farë mënyre për të nesërmen e tyre, për shtëpinë e familjen e ardhme.

Duke u mbështetur në mendimin e tërë kolektivit pedagogjik dhe dëshirës së vetë Naxhijes, ajo, veç klasës që kishte për çdo vit, u ngarkua të drejtojë edhe rrethin e qëndisjes në shkollë.

Vajzat ishin të vullnetshme dhe e mësuan shpejt punën e dorës. Pas kësaj, në çdo fund të vitit shkollor ato bënë ekspozita me punët e tyre më të mira. Shumë prej këtyre punëve edhe bliheshin nga populli. Kjo u jepte mundësi që, me të hollat e fituara, të rritnin bazën materiale të shkollës.

Urania u interesua vetë në autoritetet e qytetit për të siguruar edhe një tokë për manishte. Pas përpjekjeve të saj, shkollës iu dha një copë tokë. Aherë Urania, pasi u lidh me familjet e lagjes aty për qark, që t'i siguronin fletë mani, shpërndau farën e krimbit të mëndafshit. Ndihmë të madhe pati në këtë punë edhe nga mësuesit e vjetër Sami Dalipi e Sadik Çelo. Por kjo punë mbeti vetëm në nisje, sepse nuk u përkrah sa duhej nga autoritetet. Për këto probleme të rëndësishme Urania shkruante hapur: «Puna e dorës ka rëndësi shumë të madhe në edukatën femërore, se jo vetëm hedh gurët e parë të industrisë femërore, por edhe i shpik vajzës dashurinë për punën, rregullin, gustin estetik dhe e bën të vrasë mendjen e të favorizojnë higjienën...»¹⁾

— Për vetë natyrën femërore të shkollës sonë do të ishte mirë të krijonim një rreth për rritjen e bi-

1) Gazeta «Demokracia», 28 gusht 1926.

mëve e të luleve, — u shfaq mendimin kolegëve Urania, në këshillin pedagogjik.

— Mos vallë i rëndojmë tepër nxënëset në këto rrethe dhe u largojmë vëmendjen nga mësimet që janë më të rëndësishme? — ndërhyri Xhemileja.

— Pastaj ky rreth do të dojë, patjetër, kohë, vend, pa le pastaj sa punë. . .

— Vështirësi ka, por ato do t'i kapërcejmë. Veç kësaj puna që do të bëhet në këto rrethe është në vetvete mësim për vajzat tona. Nesër atyre u duhet jo vetëm të dinë shkrim e këndim, por dhe të mbjellin, — u dha përgjigjen këtyre pyetjeve Urania.

Dhe për këto probleme ajo shkroi dhe në shtypin lokal: «Me të tilla njohuri bujqësore do të kemi më vonë vajza punëtore, që nuk do të kenë turp të punojnë, të mbjellin e të kujdesen për to. . .»¹⁾

Pasi u rrahën mirë këto mendime, në shkollë zuri fill edhe ky rreth i ri jashtëshkollor.

Nuk e harrojnë stegopuljotet Uraninë, që gjatë pushimeve të verës nuk linte fletë pemësh të ndryshme pa mbledhur e shënuar emrat bri tyre në një fletore të madhe (herbarium). Ajo u bënte pyetje të shpeshta fshatarëve:

— Po kjo pemë si quhet, ku rritet më shumë, pse shërben?...

Nuk e harrojnë koleget e saj atë copëz të vogël toke para shkollës, ku nën drejtimin e Uranisë, vajzat e shkollës femërore u jepnin shtat luleve të bukura e të shumëllojshme dhe i ruanin ato si fëmijën e vetme.

Rrethet jashtëshkollore, që u ngritën në atë shko- →

1) Gazeta «Demokracia», 28 gusht 1926.

llë, kishin për synim të lidhnin mësimin me jetën, të edukonin dashurinë për punën tek nxënëset e të përgatitnin nëna të denja për të ardhmen, nëna që do të lindnin dhe do të rritnin më vonë fëmijë të mirë, siç i deshi koha e lufta popullore.

Dhe nxënëset e saj të dikurshme sot kujtojnë fjalët që u thoshte Urania atëherë: «Të bëheni nëna dhe amvise të mira, të ndritoni më shumë brezat...!»

EDHE VAJZAT DO TË MËSOJNË MUZIKËN E TEATRIN

Për të kurorëzuar mundin dhe përpjekjet e një viti shkollor, nxënëset, kurdoherë, në fund të vitit mësimor organizonin një ceremoni festive. Pregatitja për to bëhej qysh më parë. Zakonisht libretet e shfaqjeve i hartonte vetë Urania. Këngët, vallet dhe recitimet e zgjedhura ndiqeshin me shumë interes nga prindërit dhe nga të ftuarit që merrnin pjesë. Mbyllja e vitit shkollor kthehej në një festë të vërtetë: diku ishte hapur ekspozita e punëve të dorës, diku tjetër ekzekutoheshin ushtrimet gjimnastikore të përgatitura me kujdes. Kënga, vallja, recitimi interpretohej plot ndjenjë dhe mendim. Por për disa vjet shkolla u mbush dhe me tinguj muzikorë.

Aty rreth vitit 1924, kur Urania mori vesh se veglat muzikore i qenë shpërndarë vetëm shkollave të përziera, i tha mësuesit të muzikës të Liceut:

— Mos vallë muzika është privilegj vetëm i djalërisë dhe jo i vajzërisë, që është vetë muzikë në shpirt? Edhe vajzat do të mësojnë vegël muzikore dhe për këtë do të na ndihmosh ti.

— Unë nuk kam kohë, — i tha mësuesi i muzikës.

— Nuk është turp për ju, që duke qenë pesë hapa larg shkollës së vajzave, të mos na ndihmoni disa orë mbasditeve?...

— Por ato janë të vogla, moj Urani. Unë mirrem me nxënës mbi pesëmbëdhjetë vjeç.

— Për këtë moshë të flas edhe unë.

Mësuesi i muzikës u habit, sepse e dinte që në shkollë Urania nuk kishte vajza aq të rritura. S'kaloi shumë kohë dhe ajo erdhi tek ai, në Lice, me një fletë në dorë. Lista përmbante emrat e më se njëzet vajzave, që do të mësonin mandolinën. Mësuesi i muzikës së Liceut qeshi dhe e pyeti:

— Ku i gjete këto?...

— Mos do më tepër se kaq? Po qe se i mëson, mund të sjell edhe të tjera, — i tha me bindje Urania.

— Jo, jo! Fillojmë me kaq një herë dhe shohim e bëjmë. Por... si i grumbullove këto vajza?...

— Oh, shumë lehtë! Tetë nxënëse janë nga ato që kanë mbaruar shkollën, dhjetë nxënëse janë nga klasat e fundit të shkollës dhe tre janë mësueset e mia. Të gjitha kanë pasion për muzikën dhe unë besoj se do të mësojnë shpejt dhe mirë.

— Për veglën muzikore besoj se...

— Po, do ta blejmë vetë.

S'kaloi shumë kohë dhe kursi i mësimit të mandolinës në shkollën femërore filloi. Tingujt e mandolinës, në dorën e nxënëseve të vogla, nën drejtimin më vonë të mësuese Hasibesë, mbushën shkollën dhe më vonë shpërthyen fuqishëm edhe në Sheshin e Çerçiz Topullit:

Udhëzuesi, M. S. ...
Pas gjuhës së ...

1. Gjuhë
2. Shportë
3. Edhe

4. ...
5. ...

I. Udhëzuesi	I. Udhëzuesi	I. Udhëzuesi	I. Udhëzuesi
II. Gjuhë	II. Gjuhë	II. Gjuhë	II. Gjuhë
III. Shportë	III. Shportë	III. Shportë	III. Shportë

IV. ...	IV. ...	IV. ...	IV. ...
V. ...	V. ...	V. ...	V. ...
VI. ...	VI. ...	VI. ...	VI. ...
VII. ...	VII. ...	VII. ...	VII. ...
VIII. ...	VIII. ...	VIII. ...	VIII. ...
IX. ...	IX. ...	IX. ...	IX. ...
X. ...	X. ...	X. ...	X. ...
XI. ...	XI. ...	XI. ...	XI. ...
XII. ...	XII. ...	XII. ...	XII. ...

*«O trima luftëtarë, o bijt e Skënderbeut,
Kërkoni ju shqiptarë, lirinë e mëmëdheut.
Se mjaft në robëri, o e mjera Shqipëri,
O djem rrëmbeni pushkët, ja vdekje, ja liri!..»*

Megjithëse ky kurs muzike nuk vazhdoi gjatë, por deri në vitin 1928, përsëri, kjo iniciativë në shkollën femërore ishte shumë edukative. Nën ndikimin e këtyre punëve jashtëshkollore të mësueseve, vajzat nisën të mësojnë veç lëndëve mësimore edhe punën e dorës, të marrin njohuri bujqësore dhe muzikë. Muret, faqet e të cilave ishin stolitur me pamje nga viset e huaja, nisën t'i zbukurojnë me pamje të bukura shqiptare. Mandolinat në duart e vajzave tani nxirrnin tingujt e melodive të bukura popullore. Në jetën e varfëruar të çupërisë, që ishte e detyruar të shihte vetëm katër muret e shtëpisë, po hynte një botë më e madhe, një jetë më e gjerë. Këtë e bënë një grup «mësuesesh guximtare», siç i quajtën ato, në krye të së cilave ishte Urania. Këto të gjitha u bënë në kohë të vështira, kur pushtuesi dhe zakonet e egra rëndonin mbi kokat e vajzave, ashtu siç e thotë dhe kënga e dhimbshme e nënave tona, siç e kujton shoku Enver Hoxha:

*«... Mu te ur' e Zerzebilit
Hanushe, bilë e Bakirit,
Të vrau plumb' i qafirrit,
Pse ngrite perçen e sirit.»¹⁾*

«Pa e tepëruar mund të themi se Urania ishte edhe iniciatorja e parë e lëvizjeve teatrale në shko-

1) Enver Hoxha «Raporte e fjalime 1972-1973» f. 431.

llë dhe në masën e grave gjirokastrite. Jo vetëm që arriti të na i ngrerë në skenë, por edhe gjithë ç'luajtën, i bëri apo i përshtati vetë ajo si autore...»¹⁾

— Sot luhet drama «Besa», Naxhije, do të shkojmë ta shohim.

— Ti e di që s'ka vajza fare, moj Urani, si të vemi vetëm ne?...

— Do të ketë burra me namuz zakoni e nga paria e qytetit, — tha me qesëndi Urania. — Edhe ne midis tyre do të qëndrojmë.

Urania me Naxhijen vajtën dhe e panë dramën që shfaqej, hynë në bisedë me aktorët dhe i ndihmuan edhe me mendime konkrete. Kjo ndodhi atëherë kur reaksioni në Gjirokastrë e ngrinte fort zërin: «Vajtja e grave në tjatro nuk bie përparimin dhe lirinë, por dëmin dhe çnderimmë...»²⁾ Dhe pikërisht kundër këtyre zërave u ngrit Urania me mësuëset e tjera të shkollës femërore «Koto Hoxhi».

— Do të ngremë një grup teatri në shkollë — i tha Urania shoqes, kur ktheheshin nga shfaqja. — Ka kohë që e mendoj.

— I kemi vajzat të vogla e do ta kemi të vësh-tirë.

— Megjithatë do t'ia dalim mbanë. Teatri është një art që edukon ndjenjat patriotike, — tha Urania.

— Në fillim të japim diçka të thjeshtë e të shkurtër.

— Shumë mirë. Atëherë, që nesër le të fillojmë nga puna.

Shumë shpejt ato e vunë në jetë vendimin që morën. Teatri u ngrit dhe shfaqjet e para u ndoqën

1) Nga kujtimet e Qibrice Ciut, ish-nxënëse e Uranisë.

2) «Gjirokastra në shekuj».

me interes të madh nga shumë gra e vajza. Pjesët teatrale që përshtati e vuri në skenë vetë Urania me shoqet e nxënëset e saj si «Agamemmoni», «Kuleta e neqezit», «Fiqtë dhe dituria», «Nipi i këpucarit», etj. komunikuan drejtpërdrejt me grarinë e asaj kohe. Temat e tyre mbi padrejtësitë shoqërore të kohës, mbi pozitën e shtypur të gruas, preknin atje ku i dhimbte shpirti gruas. Ndaj dhe ato u pritën me shumë entuziazëm. Shfaqjet shquheshin për interpretimin e tyre të thjeshtë e plot ndjenjë, me të cilat luanin vajzat e shkollës.

Nuk e kanë harruar edhe sot nënat gjirokastrite një program me këngë në formën e një dialogu me kor e soliste. Një vajzë veshur me të zeza, simbol i Shqipërisë së mjeruar e të robëruar të atyre viteve, dhe kori i veshur me funde e bluza kuq e zi, që përfaqësonte brezin e ri shqiptar.

Nëna: «...O bijt e mi, e bijatë,
I shtyni syt' tek të mijatë,
Përse më latë të shkretë sot,
E mjera vdes e s'duroj dot

Kori: O mëmëzë e dashur,
Ç'na je kështu, e ç'pate ti,
Përse na je helmuar,
Përse na qan e na mban zi?

Nëna: Ju, bijt' e mi dhe bijatë,
S'më doni më e s'kini mall,
Gjithkush kërkon të tijatë,
Më lanë e vdes në hall.

*Kori: O mëmëzë ne bëmë faj,
Po falnaje, se paskëtaj
Të gjithë ne, që sheh me sy,
Do të përpiqemi për ty...»*

E shkruar, e vënë në skenë nga Urania, kjo ishte një thirrje e hapur për kushtrim, thirrje për detyrën fisnike të çdo shqiptari ndaj Shqipërisë.

Tërheqja e nënave dhe e vajzave të Gjirokastrës në shfaqje të ndryshme, në kohën e zymtë të regjimit antipopullor, ishte një akt mjaft i rëndësishëm politik.

«DO T'I BOTOJ NË KOHË TË VOLITSHME»

Kodra e Varoshit dhe Këculla ishin vendet më të preferuara të Uranisë. Me një fletore të vogël në dorë ajo dilte ngaherë e rrinte orë të tëra aty, në heshtje, e menduar. Asaj i pëlqente shumë pamja e Gjirokastrës, që hapej aty para, kalaja shekullore, dëshmi e trimërisë shqiptare; i pëlqenin rrugët e gurta e të ngushta të qytetit, shtëpitë e ngritura si mbi njera-tjetrën, pjerrësia e tij e veçantë.

Me sytë të tretur mbi qytet, aty nga maja e Këcullës, po hynte çdo ditë, në një fletore ditari, jeta e saj e thjeshtë, e pastër. Po hynin në këtë fletore dhe vargjet e autores së re, nisma e të cilave ishte që nga Goricela e Stegopulit. Tashmë në tonin e pasqyrohej, në mënyrë realiste, edhe jeta e rëndë e popullit tonë në regjimin antipopullor të Zogut:

— Mendoni sa të zhveshur janë në këto orë,
Sa vdesin nga uria, ngrijnë, ndërën dorë;
Sa nuk kanë as doktor, as barna fare s'pinë,
Mjer, kur nuk ndjejnë zemrat, qeshin për
varfërinë!...

Me katër vargje të thjeshta autorja arrin të na japë një aspekt realist të jetës së zezë të popullit. Madje në vargun e fundit ajo arrin të diferencojë shkaktarët e kësaj gjendjeje dhe mban një pozicion armiqësor kundrejt tyre.

Mjerimi i masave dhe revolta kundër kësaj gjendjeje do të bëhet shpesh motivi i disa krijimeve të saj. Krijimtaria e paktë dhe e thjeshtë e Uranisë me këtë temë jep një kontribut modest në trajtimin e gjendjes së mjeruar të popullit tonë, që më vonë do ta shohim aq fuqishëm te Migjeni e më pas te Qemal Stafa e të tjerë.

Por duhet pohuar se, megjithëse Urani Rumboja e pa dhe e përshkroi me dhembje këtë mjerim, ajo nuk arriti ta diferencojë në shkrimet e saj dhe as të përcaktojë shkaktarët e vërtetë të tij, për të sugjeruar si rrjedhim rrugëdaljen. Ashtu si gjithë iluministët për pikëpamjet e të cilëve ajo ishte zëdhënëse, e kishte shikimin të drejtuar më shumë te shkollla, te dituria e përparimi, si rrugë kryesore për përparimin e kombit. Këtë, pa dyshim, e justifikon koha dhe rrethanat në të cilat jetoi, punoi dhe shkroi Urani Rumboja.

Ja si e përshkruan ajo në mënyrë simbolike gjendjen e Shqipërisë së robëruar në një këngë të hartuar për vajzat e shkollës:

«...Dy, more, dy pëllumbëza të mjera
Fluturojnë nëpër ferra.
Njëra kish rroba jeshile,
Tjetra i kish trandafile;
Njëra qante robërinë,
Tjetra këndonte lirinë.
E para ëmbël vajtonte,

*E dyta bukur këndonte.
Nga more, nga vinin pëllumbat tona,
Nga Tomorri e nga Dodona,
— Në këng' e në vaje ç'donin të na thonin?
— Na gëzonin, na helmonin...»*

Por në fund mbyllja e këngës bëhet entuziazte, kur ajo, duke u mbështetur tek autorët e Rilindjes sonë Kombëtare, thotë:

*«. . .Kënga e vaji ynë u tregon, o bija,
Kapni pushkën për liri,
Tek ju shpreson Shqipëria...»*

Motivi kryesor në krijimet e Uranisë ka qenë heroizmi shqiptar dhe tradita jonë e lavdishme. Duke evokuar në vargjet e saj, që i mësuan dhjetëra nxënës, periudhën e lavdishme të Skënderbeut, ajo përpiqet të ngjallë tek nxënëset e saj ndjenja të forta të patriotizmit tonë kombëtar:

*«...Kur në rrezik ndodhet Atdheu
e vuan fort,
Më vjen në mend trim Skënderbeu
e shkruaj plot...»*

Qëllimi që i kishte vënë vetes që të përhapte në masën e grave shkrim e këndim, kulturë e përparim, bëhet dhe ai motiv i shumë këngëve të saj.

*«...Gati, gati, gatitu, bijë shqipëtare,
Me ushtrim stërvitu, si trime shkollare.
Mësoju, o bijë, kij qytetërim,
Lëvdoje Shqipërinë, nga ti pret shpëtim...»*

Atë që thoshte përdita puna dhe përpjekjet e saj, ajo e thotë, edhe nëpërmjet vargjeve si këto:

*«Ta ngresh nënën e dashur,
Që ka rënë përdhé,
Se atë e ka pllakosur¹⁾
Padija rrufe...»*

Nga këto vargje del thirrja e saj për shkollë, vendosur këtë herë në një kuadër më të gjerë, më të plotë, në kuadrin e interesave të atdheut. Kjo thirrje, ky motiv është vazhdimi i mendimit patriotik të rilindasve, për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës kombëtare nëpërmjet shkollave. Është bindje e Ura-ni Rumbos që shkolla dhe arsimimi i masave do ta çonte Shqipërinë tek një e ardhme e ndritur. Puna dhe vargu i saj, është plotësimi i punës e i përpjekjeve të një plejade të tërë patriotësh lunxhotë, që nga Kotua e Pandeliu, Nane e Lame Petri²⁾, Sevo Pasha, Risto Lafi, Janko Minxha etj., që u përpoqën tërë jetën për shqipen dhe Shqipërinë.

Kënd vështrimi kryesor i vargut e i punës së saj ishte pa dyshim shkolla femërore. Janë të shumta poezitë shkollore të saj, me karakter të theksuar edukativ. Përmes tyre ajo arriti të trokasë shumë shpejt në ndërgjegjen dhe në zemrën e vajzave dhe të grave. Dhe këtë e bënte duke evokuar gjithmonë trimërinë shqiptare:

1) shtypur

2) Nane Petri nga Saraqinishtu, patriot rilindas, një ndër 27 burrat që firmosi kanonizimën e shoqërisë së shkronjave në Stamboll. Lame Petri, i nipi i tij.

«...Një trimosh, trimosh i vogël,
Pse s'po han, pse s'po këndon,
Shikon dyfekun, i thotë:
— Rrofsh, o shoku im i fortë,
Sa herë më ke shpëtuar
Nga duart e armiqve,
Që më ndiqnin në brigje...»

Vargjet e mësueses së re, shpesh edhe me përshtatje të ndryshme, siç shihet, janë tepër të thjeshta. Ndonse të paarrira plotësisht nga ana e mjeshtërisë poetike dhe pa limën e duhur metrike, ato kanë një vlerë të konsiderueshme për faktin se janë shkruar nga dora e vajzës shqiptare, në një kohë të rëndë kur femrës nuk i jepnin as të drejtën e daljes, e shikimit e jo më të fjalës e le pastaj të vargut. Mbi këtë errësirë u ngrit zëri i pastër e patriot i mësueses Urani Rumbo.

Pas zërit të autores së parë me origjinë shqiptare, Helena Gjikes, po hynin tani, megjithëse tepër lokale e me tematikë të ngushtë, vargjet e thjeshta të Urani Rumbos. Këto vargje nuk dolën në shtypin e kohës dhe as u mblodhën në një libër të veçantë, sepse, siç pohon ajo vetë: «do të botohen në kohë të volitshme»¹⁾).

Por të gjitha ato hyjnë e ruhen edhe sot në mendjen e zemrat e grave dhe të vajzave të dikurshme gjirokastrite të aneve dhe nënave të sotme të Gjirokastres. Vargjet e saj vijnë të thjeshta, të freskëta dhe edukative edhe sot në ditët tona.

Janë të shumta edhe dramat e përkthyer, ose të përshtatura ose dhe të shkruara prej Uranisë.

1) «Arsimi popullor» Nr. 4, 1964.

Edhe me këtë gjini letrare, qoftë ky përkthim ose krijim i saj, duken përpjekjet e një pune të palodhur të mësueses patriote. Të ngritura në skenë, këto drama lanë mbresa të forta në mendjen e nënave gjirokastroite. Nuk është harruar edhe sot drama e Uranisë «Theroria e Ifijenisë», shkruar e vënë në skenë po prej saj në maj të vitit 1925-1926. Megjithëse me temë historike nga lufta e Trojës, autorja ka ditur të japë nëpërmjet saj ndjenjën e atdhedashurisë së thellë. Diku protagonistja e dramës, Ifijenia, thotë:

«...Erdha, ati im, me gëzim të jap jetën time për hir të Atdheut. Uroj të lavdërohen armët e Atdheut e të fitojmë... dhe ti, Atdheu im fort i bukur, për të cilin sot vdes me kënaqësi, rrofsh e qofsh i lumtur...!»¹⁾

Në gjithë punën dhe përpjekjen e madhe të Uranisë, është dëshira e saj e madhe për arsim e kulturë, kurse në krijimet e saj të thjeshta gjendet besimi dhe optimizmi i patundur i autores për të nesërmen e ndritur të gruas shqiptare.

1) Urani Rumbo «Theroria e Ifijenisë».

«S'FLUTURON ZOGU VETËM ME NJË KRAH»

Syri dhe mendja e një mësueseje kërkuese e punëtore të palodhur, siç qe Urania, do t'i kapërcente patjetër muret e një shkolle. Gjithë poetët e Rilindjes, kush më shumë e kush më pak, e trajtuan problemin e gruas, ndërsa koha kur punoi Urania, sidomos periudha e viteve 1920-1924 do ta ngrinte këtë problem në shkallën e një problemi shoqëror e politik. Në radhën e shumë grave përparimtare: Marigo Pojzo, Evdhoksi Gërmenji, hyri edhe emri e puna e Urani Rumbos.

Ishte nëntori i vitit 1920, kur në Gjirokastrë gratë u mbledhën dhe rrahën me njëra-tjetrën gjendjen e tyre të rëndë.

Kjo bisedë si motra me motrën u bë me Urani Rumbon, që «u foli si fshatare fisnike qytetareve të zeza të mbyllura brenda mureve të zakonit të vjetër». ¹⁾ Dhe fill pas kësaj ato vendosën të krijojnë «Lidhjen e gruas», e cila u themelua më 23 nëntor 1920. Gjithë fjalën e zërin e grave Urania e mbledhi me një protestë të fortë, që e botoi në gazetën

1) «Gjirokastra në shekuj».

«Drita», në emër të «Lidhjes së gruas», e që jehoi në tërë Shqipërinë.

«Kur të këndonit kërkesat tona, që ju paraqesim botërisht, mos u trembni e të vini në shtëpitë e të na bërtitni!.. Besoni, kemi lidhur fjalën të ndodhemi e të flakim mendimet tuaja të bëra kundër nesh»¹⁾, përfundonte protesta.

Ishte bashkuar në këtë protestë zëri i aneve, i nanave, i vajzave gjirokastrite, të cilat Urania i mbloodhi në shoqërinë e parë «Motërmatë». Urania i mbloodhi ato në një front të përbashkët si motra të vërteta, për të luftuar zakonet e vjetra, që i mbytnin, që i mbyllnin brenda dritareve me kafaz e perde të rënda, i mbanin nën perçen e zezë, i mplaknin para kohe, e ua bënin jetën më të zezë se nata, më të rëndë se guri.

— Një gjë është e vërtetë, motra. Zëri ynë është i drejtë, një zë që kërkon përparimin e zhvillimin e gruas. E dini? Shoqëria është si një zog me dy krahë. Njëri krah i zogut jemi ne, gratë: Kështu siç jemi tani, të mbyllura, pa zë, pa fjalë, pa punën tonë, ne s'rrahim dot dhe s'jemi krah i shëndoshë, për fluturim. Por, a mund të fluturojë një zog vetëm me një krah...?

— Jo, patjetër që s'fluturon dot, — thoshnin gratë.

— Atëherë edhe shoqëria, që lë gratë mbrapa nga dituria, mbetet në vend si zogu me një krah.

Duke i rrahur gjerësisht këto mendime, që preokuponin tërë gratë, me fjalë të ngrohta dhe Urania mbloodhi në shoqërinë e sapokrijuar «Motërmate» me

1) Gazeta «Drita» 23 nëntor 1920.

dhjetëra gra nga familje të thjeshta e të ndershme gjirokastrite.

Kjo bërthamë grash përbën shkëndijat e para të luftës për përparimin dhe emancipimin e gruas, luftë që më vonë dha flakën e madhe të çlirimit të plotë të gruas dhe që arriti ta bëjë vetëm Partia me në krye shokun Enver Hoxha. Duke u lidhur me njëra-tjetrën pa dallim feje, ato kishin për qëllim thellimin e traditave më të mira shqiptare, siç pohonte vetë Urania:

«Ne duhet të forcojmë ato zakone të mira që gjer sot i kanë mbajtur të larta e të lavdëruara femrat tona, e të thithin si bleta nga ato të botës që mund të pajtohen me tonat, për plotësimin e detyrës së lartë që femra ka kundrejt shtëpisë, shoqërisë e mëmëdheut»¹⁾

1) «Shpresa kombëtare», Vlorë 1921.

SHOQËRIA «PËRMIRËSIMI»

Në prag të Revolucionit të Qershorit, kur problemi i gruas u shtrua në bisedat e «Këshillit të Naltë» të Qeverisë, kur Fan Noli thoshte se «Një komb që ka gruan në një gjendje të mjerë nuk mund t'i japë shtetit ushtarë të mirë. Gjendja e gruas shqiptare është çështje që duhet të na interesojë. është vitale për jetën tonë...», kur në zgjedhjet e Asamblesë Kushtetuese në parlamentin shqiptar në vitin 1923, u diskutua edhe çështja e së drejtës së votës për gruan, në të gjitha këto lëvizje gruaia s'qëndroi pasive. Krahas shoqërive të tjera «Shpresa Kombëtare» në Vlorë, «Shqiptarka» në Tiranë, «Zhvillimi» në Korçë, krijohet edhe në Gjirokastrë. më 25 korrik të vitit 1924, nën drejtimin e Urani Rumbos, shoqëria «Përmirësimi», vazhde e shoqërisë së mëparshme «Motërmatë».

Atë ditë korriku, në shkollën femërore ishin mbledhur dhjetëra gra të lagjeve të ndryshme. Ka rëndësi të themi se në shkollën femërore kishte vajza nga çdo lagje e qytetit. Kjo u dha mundësi mësueseve të kësaj shkolle të lidhen nëpërmjet fëmijëve thuajse me të gjitha familjet gjirokastrite, të

njohin çdo hall të tyre e të drejtojnë punën e ndihmën e tyre. Edhe në këtë mbledhje kishte gra e vajza të çdo lagjeje të qytetit, kur Urani Rumboja u foli:

— Në qytetin tonë ka shumë gra e vajza të zgjuara, të virtytshme, arsimdashëse e mike të përparimit. E kërkon koha, e kërkon secila nga ne, që të mblidhemi, të diskutojmë dhe të gjejmë rrugët se si duhet të shkundemi nga padrejtësitë shoqërore që na kanë rënë në kokë. Pikë së pari, për të zhdukur analfabetizmin në radhët tuaja, do të zhvillojmë një kurs gratis me njohuri gjuhe, aritmetikë, çdo të premtë e të diel mbasdite¹⁾.

— Për të mësuar ne s'na e pret koka tani, — tha njëra si më e moshuar.

— Po mësimë praktike do të ketë? — pyetën gratë.

— Do të ketë një ose dy herë në muaj mësimë mbi ekonomi shtëpiake, të higjenës dhe edukatën morale të fëmijëve. Këto do të jepen në formë konferencash — sqaroi Urania.

— Këto janë të mira se do arrijmë të mësojmë diçka, — foli një grua ngadalë.

— Të gjitha që tha janë të mira, — u hodh një tjetër.

— Di të shkruash e të lexosh ti?

— Jo, s'di, po ç'e dua fare. Unë e hëngra çairin tani.

— Flet e mendon gabim. Sa të rrojmë, le të mësojmë, të mirë do të kemi, moj gra, kështu e tha edhe mësuesja.

1) gazeta «Demokracia», 5 janar 1926.

— Shtëpia sot do punë, do krahë e jo kokë si jona. Krahët ja tek i kemi!

Urania, që kishte kohë që i ndiqte këto biseda, buzëqeshi pak dhe u foli:

— Atdheu, shoqëria, familja ka nevojë për mëma e motra të mësuara, të përgatitura që të edukojnë fëmijë të mirë, që do t'i duhen Atdheut.

Diskutime pati shumë e me mendime të ndryshme. U miratua statuti i shoqërisë së re.

— Më shkruaj mua në atë fletore, — u hodh njëra.

— Edhe mua..., edhe mua...

Lista u mbush plot qysh në datat 24, 25 korrik 1924 me gra e vajza nga «Varoshi», «Manalati», «Palortoja», «Pazari i Vjetër» etj. Pjesa më e madhe e tyre ishin nëna të nxënëseve të shkollës.

Më 5 janar 1926 Urania u bën thirrje grave, nëpërmjet shtypit: «I ndershmi popull, merr pjesë dhe përkrah me shpirt këtë shoqëri mirëbërëse, që nuk u krijua me ndonjë qëllim interesi vetjak, por vetëm për interes të paravajtjes tënde morale e materiale»¹⁾. Shoqëria veproi kur reaksioni ziente kundër lëvizjes së gruas dhe po i hiqte asaj çdo të drejtë, kur çdo përçapje e tyre ndiqej me sy të shtrembër e kur shumë vajza të reja po bëheshin viktima të thashethemeve.

Ishte muaji dhjetor, kur në qytet plasi një thashethemë e re.

— E more vesh, moj e zezë?... Vajza e rritur katërmëdhjetvjeçare iku nga shtëpia pa thënë fare...

— Po ku të jetë, vallë, me cilin do të ketë ikur?...

— Uh, dhe ti, ja, me atë bandillin e lagjes tjetër

1) Gazeta «Demokracia», 5 janar 1926.

më thanë. E kishin parë edhe nga Ura e Lunxhërisë.

Atë ditë, në darkë, gjithë Gjyrokastri gumëzhiu:

— Një vajzë nga «Hazmurati» u gjend e mbytur në lumë...

Nën presionin e thashethemeve të reaksionit, që i favorizonte e i nxiste këto situata, gjendja ishte bërë e elektrizuar.

Të nesërmen Urania, me Naxhijen, Hasibenë, Xhemilenë etj. (koleget e saj), hyri nëpër shtëpitë e kësaj lagjeje.

— Jo, jo. Nuk kemi ardhur për kafe sot, por për diçka më të rëndësishme. Pëshpëritet vesh më vesh e portë më portë me fjalë të liga, thethaçe. Ato duhet t'i mposhtim, motra, se na ndajnë nga shoqi-shoqi, na largojnë nga rruga jonë e madhe. Ajo vajzë e re e lagjes suaj, që do të jepte nesër aq shumë për shoqërinë, u mbyt në llumin e gojëve të liga, — thanë mësueset.

— Ne nuk hapëm gojën fare për atë, moj mësuese — shfaqësohej njëra.

— Sa për atë, mirë e bëri, e dridhte bishtin, ndaj...

— Ajo që vajzë e mirë sa s'thuhej këtu në gjitoni...

— Vajzat tona janë shumë të mira, të ndershme, siç e do zakoni ynë shqiptar, plotësonin ato. — E kemi për detyrë t'i mësojmë, të mos flasim poshtë e përpjetë për to, por të ndalojmë edhe të tjerë. Hajdeni, moj motra, të mësoni në kurset tona...

Këto takime bëheshin vazhdimisht në çdo shtëpi me mësueset ose nëpër mbledhjet e konferencat e shpeshta që organizonte shoqëria.

— E kemi detyrë, si anëtare të kësaj shoqërie, të luftojmë gjuhët e gjata dhe llafet e liga, se na

krijojnë të çara midis nesh, — i porosiste ngahera Urania, kur mblihdeshin herë te shkolla femërore e herë në shkollën «Drita», ku ishte më e lehtë për të ardhur gratë e lagjeve të sipërme të qytetit; të cilat s'duhej të kalonin nga rrugë me shumë njerëz ose nga mesi i pazarit.

Viti 1923 hapi dyert e Liceut. Kësaj ngjarjeje të rëndësishme Urania i bëri jehonë të madhe në konferencat e grave.

— E shoh që trembeni t'i dërgoni vajzat në Lice, — u thoshte Urania.

— Plot i kanë pesë klasë, moj Urani, për shtëpinë e tyre.

— Na duhen vajza të shkolluara. I kërkon mëmëdheu ynë, i kërkon jeta të tilla. Të ngrihem i mbi zakonin dhe t'u hapim rrugë vajzave tona, — ndërhyri Naxhija.

Vështirësi pati shumë, por më së fundi vajzat u futën në Liceun e Gjirokastrës, ashtu si dhe në atë të Korçës. Për këtë punuan pa u lodhur mësueset e shkollës femërore, për të cilat shoku Enver Hoxha thotë:

«Vajtja për herë të parë e vajzave në Lice ishte gjithashtu një gëzim i madh. Për këtë kishin punuar pa u lodhur mësueset Urani Rumbo, kjo organizatore e shquar e arsimit dhe e emancipimit të vajzës gjirokastrite...»¹⁾

Qysh prej vitit 1924-1925 shumë gra e vajza nisën të mësojnë në kurset kundër analfabetizmit. «Sot jemi në gjendje të lexojmë vetë gazetën, fjalën e Partisë, — na thanë shumë nëna të moshuara, — vetëm nga mësimet në këto kurse. E zonja qe

1) Enver Hoxha «Raporte e fjalime 1972-1973» f. 431.

Urania, s'na la qorre në jetë...». Dhe po t'i pyesësh nëse mbajnë mend diçka prej fjalës së saj, ato të thonë vargjet e Naimit, Çajupit e të Kotos aq mirë, sikur t'i kenë mësuar dje.

Organizatore e zonja, Urania arriti të fusë dashurinë për teatrin edhe në radhët e grave. Ajo i nxori ato në skenë, kur arhondët, mehmurët, agallarët dhe paria konservatore e qytetit mbushnin faqet e shtypit periodik mbi ruajtjen gjoja të nderit femëror nga kjo rrugë «e tepruar e teatrit».

Por, njerëzit përparimtarë të kohës, midis tyre edhe Urania, iu kundërvunë e i mbrojtën në shtyp këto iniciativa, që kishin të bënin me përkrahjen e teatrit. «Kundërshtoni teatrin që u lojt për gra? Mirë që s'e kundërshtoni edhe për burra?... Kundërshtoni kapelen?... Pse s'kundërshtoni edhe rrobat: p.sh. pantallonat, palltot, jelaqet, etj., që janë zakone të ra e që po përdoren njëzet vjet e këtej...»¹⁾

Në mbrojtje të gruas u ngritën më penë në dorë arsimtarët e vjetër Thoma Papapano e Hysni Babameto. Ata dolën hapur kundër errësirës në të cilën mbahej gruaja, sepse e kishin të qartë, siç shprehehin se «Nga të ngriturit e gruas varet edhe qytetërimi, përparimi dhe rrojta e Shqipërisë...»²⁾

Reaksioni i kohës, regjimi obskurantist zogollian nuk heshti asnjëherë dhe bëri ç'mundi për ta penguar këtë lëvizje; por, krahas kësaj nuk heshti për asnjë çast as puna dhe pena e Urani Rumbos, mes shumë patriotëve të tjerë. Në këtë rrugë të vështirë, por me dritë, ajo pati oranë gjithnjë për-

1) «Gjirokastra në shekuj»

2) Po aty.

krahjen dhe ndihmën e patriotit të madh shqiptar, Bajo Topullit, me të cilin kishte miqësi familjare.

Dramat e shkruara e të vëna në skenë «nga regjisorja profesioniste»¹⁾ Urani, u luajtën dhe u panë nga dhjetëra gra e vajza gjirokastroite. Problemet që ngriheshin në to kundër padrejtësive shoqërore, kundër regjimit të kohës, ndikuan shumë në zgjimin e ndërgjegjes e të mendimit të tyre përpërimtar. Urania arriti jo vetëm të thyejë një zakon të lashtë, se ishte e para herë që gruaja merrte pjesë në jetën kulturore, por mundi të sigurojë një shteg shumë të fortë, nga ku mund të drejtonte me shoqet punën e vështirë për emancipimin e gruas.

Ishte gushti i vitit 1926 kur Urania u shkruante grave në gazetën «Demokracia» në formë thirrjeje e lajmërimi: «Ju njoftojmë se ashtu siç e kishim lënë me fjalë qysh në mbledhjen e parë, me lekët e grumbulluara nga shfaqjet e teatrit, u blenë dy makina qepëse. Ju ftojmë të gjithave të merrni pjesë për të mësuar të qepni e të qëndisni...»

Gra e vajza nga çdo lagje e qytetit mbushën klasat e shkollës femërore.

Urania hynte e dilte nga klasat dhe i bëhej zemra mal për gatishmërinë e zellin e tyre, për dëshirën dhe asimilimin e shpejtë të zanatit. Në një shkrim në gazetën «Drita», po këtë vit, ajo shkruante: «Si mike e përparimit dhe e veprave mirëbërëse u entuziasa kur pashë vajzat tona të mësojnë zanat artistik, i cili siguron të ardhmen e tyre dhe i shpie në lumturi e nder, se, siç dihet, puna është nder...»

Nëpër konferencat e shpeshta të shoqërisë u fol

1) Kështu e quajtën bashkëkohëset.

shumë herë për mënyrat e rritjes së fëmijës, për kujdesin për të sëmuret, për administrimin familjar, për detyrat e çdo nëne kundrejt familjes. «Çerdhja e sjelljes, e përshtypjeve të para të fëmijës është familja — u thoshte ngahera nënave nëpër mbledhje Urania. — Tek ne edukimi familjar është lënë mënjanë e pritët vetëm nga shkolla. Prindërit e shkojnë ditën nëpër llukanto.¹⁾ Në darkë, të mërzi-tur nga hallet, duhani, alkooli mbyllen në shtëpi e zënë grënjën me gratë. Kjo u jep fëmijëve edukatë negative, duke i mbushur me superticione, cmir etj....»²⁾

Ashpër kritikoi Urania në shtyp lluksin e grave të parësisë, që qëndronin larg problemeve shoqërore. Urania mësonte gratë e vajzat se ishte e domosdoshme të trazoheshin dhe ato në jetën shoqërore, sepse e kërkonte koha dhe e mira e përgjithshme. Ashtu të mbyllura brenda mureve, siç rrinin shumica e tyre, e larg problemeve të kohës, kombi s'kish asnjë të mirë veç së keqes. Edhe shtypi përparimtar i kohës i ngrinte këto probleme aktuale: «Trimi pa grua mund të barazohet si gërshëra me një teh të vetëm dhe burrëria nuk mund të gjallërojë, përparojë e veprojë për të mirë e lumturi, pa graninë...»³⁾. Lëvizja e shoqërisë së grave në Gjirokastër vepronte pikërisht atëherë kur reaksioni, feja, regjimi në fuqi, e quanin pabarazinë shoqërore të gruas si një fenomen «të pandreqshëm». Kjo shoqëri vepronte gjithashtu krahas shumë shoqërive të tjera demokratike në qytet, sidomos krahas shoqërisë «Bashkimi», de-

1) llukanto (barbarizëm) = restorant.

2) Gazeta «Demokracia», 7 gusht 1926.

3) «Gruaja shqiptare», 23 shkurt 1920.

gë e shoqërisë me po këtë emër, të formuar në Tiranë më 13 tetor 1922, e cila mes tjerash kërkonte edhe zhvillimin e gjithanshëm të gruas shqiptare, që edhe ajo të merrte mësim njësoj si burrat. Anëtarët e kësaj shoqërie ishin të parët që i dhanë shpirt lëvizjes demokratike të qershorit 1924, ishin ata që bënë një shpallje më 16.6.1924, në të cilën kërkonin edhe pastrimin e aparatit shtetëror nga elementët bejlero-çifligarë.

Shoqëria e grave eci e u zhvillua krahas shoqërive të tjera patriotike si: «Studenti», «Lidhja e Punëtorëve», «Lidhja e Mësuesve» të Gjirokastrës etj. «Lidhja e Mësuesve», ku bënte pjesë edhe mësuesja Urani Rumbo, u krijua pas Kongresit të Lushnjës e pas Luftës së Vlorës, kur, siç thotë shoku Enver Hoxha, çështja agrare dhe çështja e demokratizimit u bënë çështje kryesore në jetën politike të vendit.

Lëvizja e mësuesve përparimtarë të viteve 1921-1924 ishte pjesë e frontit antifeudal e antiimperialist të vendit. Qëllimi i lidhjes së mësuesve ishte që të luftonte për mbrojtjen e të drejtave të mësuesve e të përpiquej për zgjerimin e rrjetit arsimor, si një faktor i rëndësishëm për lartësimin e kombit, të luftonte për pjesëmarrjen në shkollë të vajzave krahas djemve, e të mundahej të hapte shkolla atje ku nuk kishte. Këto detyra të qarta me karakter të mprehtë politik e social, synonin të zgjidhnin disa nga problemet kryesore shoqërore, që kishte shtruar zhvillimi ekonomik-shoqëror i shoqërisë shqiptare në atë kohë.

Shoqëria «Lidhja e Mësuesve» drejtohej nga patrioti i shquar nga Libohova Avni Rustemi, njëri nga pionierët e parë të lëvizjes për arsimin shqip

në rrethin e Gjirokastrës pas Koto Hoxhit e Pandeli Sotirit, që, siç thekson shoku Enver Hoxha «...s'kursyen as jetën për shkollën tonë, për gjuhën tonë të bukur amtare, për dritën e përparimit»¹). Krahas zërit e hapit të mësuesve të kësaj shoqërie, hyri edhe zëri e hapi i Urani Rumbos. Krahas jetës e punës së këtyre shoqërive, eci edhe jeta e puna e shoqërive të grave gjirokastrite.

Me gjithë pengesat e ndërhyrjet e vazhdueshme të regjimit obskurantist zogollian, shoqëria e grave e zhvilloi pandërprerje veprimtarinë e saj. Për këtë më 21.8.1926 e më vonë më 1927, gazeta «Demokracia» deklaroi: «Shoqëria «Përmirësimi» mund të themi se është e vetmja që punon me mish e me shpirt për paravajtjen e seksit femëror në Gjirokastrë. Me të punojnë mjaft vajza jetime dhe mbli-dhen gratë e vajzat përparimdashëse, për të mësuar të qepurit e të qëndisurit. Ju lumtë grave tona, që lanë larg mjaft hapa djemtë e burrat...!»

Gjer në vitin 1933, vit kur Urania u detyrua të largohet nga Gjirokastra, ajo nuk e ndaloi asnjëherë punën e saj me shoqëritë e grave, krahas punës së madhe që bënte me shkollën. Bashkë me shoqet e saj të para, si dhe me mbështetjen e përkrahjen e grave e të vajzave gjirokastrite, ato i bënë shkollën femërore dhe shoqëritë e grave qendra të edukimit patriotik, të edukimit kulturor e sportiv, të organizimit të përparuar të jetës në familje e në shoqëri.


Këto vatra edukimi e mbajtën kurdoherë të ndezur prushin e patriotizmit shqiptar dhe urrejtjen karshi regjimit antipopullor të Zogut.

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1972-1973», f. 430.

«... RRUGA IME MË E MIRË, ËSHTË KJO
QË KAM NISUR...»

Puna plot pasion e Urani Rumbos për arsimimin dhe përparimin e grave dhe vajzave gjirokastrite patjetër nuk i shkonte përshtat regjimit antipopullor të asaj kohe, parisë konservatore, fesë. Për ta larguar mësuesen e palodhur nga rruga e saj e nisur, për të penguar veprimtarinë e saj si udhëheqëse e grarisë, më 4 korrik 1930, ajo u akuzua zyrtarisht, nga autoritetet arsimore të asaj kohe, se gjoja kish lejuar nxënëset të dilnin me çorape të modës dhe, me kokën e saj, po përgatiste me vajzat e shkollës shfaqje teatrale. Akuzat ishin të pathemelta. Urania më datën 19 korrik 1930, me anë të një shkrimi në gazetën «Demokracia» u drejtohet gjithë lexuesve gjirokastritë, për pafaktësinë e akuzave. Një publikim i tillë dhe diskutimi i zjarrtë, që mori shkas nga kjo, në tërë masën e qytetarëve, sidomos të vajzave e të grave, të cilat e donin, e çmonin dhe e nderonin shumë Uraninë, bëri që vendimi për transferimin e saj të prapset për atë vit.

Por urrejtja e elementëve obskurantistë dhe reaksionarë të regjimit antipopullor nuk iu ndanë asnjëherë Uranisë. Ishte ky sy që e ndiqte prej shu-



Urani Rumboja midis nxënëseve të saj, në shkollën femërore
5-klasëshe të Gjirokastrës.



Urani Ramboja midis nxënëseve të saj, në shkollën femërore
5-klaseshe të Gjirokastër.

më vjetësh me radhë. Kjo bëri që më 15 gusht 1933, përmes autoriteteve arsimore, t'i dërgojnë transferimin për në Vlorë, si mësuese.

Ishin ditët e fundit të gushtit. Ajo kish qenë në shkollën femërore për t'u takuar me koleget e saj dhe tani po kthehej tek nënë Kaliopi krejt e vrarë dhe e dërrmuar shpirtërisht. Po sa u çudit kur pa nënën e saj, Athinanë! Ajo sa kishte ardhur nga fshati. Urania iu lëshua në krahë me mall e dashuri. Por, si të ishte kujtuar për diçka, ngriti kokën e pyeti me rrëmbim:

— Si u bë babai, mama?.. Morët lajm nga Kornili?

— Isha vetë unë tek Kornili, — i tha e ëma shumë ngadalë.

— Pse? — pyeti menjëherë Urania dhe e vështroi drejt në sy.

E ëma heshti... dhe iu varën lotët nëpër faqe.

— Si?... mos vdiq babai?... Ah, po pse, pse s'më lajmërove...? — Dhe u lëshua në gjoks të nënës, duke qarë me ngashërim. Do të kishin mbetur shumë gjatë ashtu, në qoftë se nuk do të hynte nënë Kaliopi, që u solli një kafe të rëndë. Biseduan gjatë për babanë, por e ëma e preu bisedën dhe e pyeti:

— Ti si i ke punët e tua, moj Urani? Ç'po ndodh kështu me ne, moj Kaliopi? — iu drejtua pastaj gruas që kish qenë si nënë e dytë për Uraninë.

— Mos u mërzit, Athina. Unë mbeta shumë e re pa burrë dhe e përballova jetën vetë. Sa për Uraninë, hiç mos kij merak. Të thonë ç'të duan shpirt-humburit. Dëshmitari më i mirë jam unë, që e pata tërë kohën në shtëpinë time këtë vajzë.

Urania nuk po ia vinte veshin bisedës së tyre. Qante në heshtje. I vinte keq që babai kish vdekur

me brengën e madhe në shpirt, të atyre ngjarjeve që i kishin ndodhur asaj. I vinte ai para syve dhe i oshëtinin në vesh fjalët e tij, para se të nisej. Atëherë i kishte thirrur pranë krevatit të tij Uraninë dhe Thanasin e u kish thënë:

— Keni nisur rrugë të drejtë, por të vështirë. Është e domosdoshme të mos e lini përgjysmë, se ndryshe s'do më tretë dheu. Haram edhe mundimet që u rritëm e u shkolluam.

Pastaj Urania solli ndër mend menjëherë bisedat në sheshin e Rrepeve në Stegopul me babanë e mësuesin e fshatit Sevo Pesha.

— Gjuha jonë është shumë e vjetër. Do të thoshja edhe më e vjetër edhe nga greqishtja, — e kishte filluar bisedën Sevoja.

— Ku e mbështet këtë mendim ti, mor Sevo? — e kishte ndërprerë Spiroja si më i regjur në këto punë, por që i pëlqente të hapej e të bisedohej kjo temë e preferuar për të.

— Pse shumë fjalë të greqishtes, dhe sidomos emra perëndish e heronjsh të mitologjisë së saj, shpjegohen etimologjikisht vetëm me gjuhën tonë. Ja, ai emri i Akilit, «të shpejtë» (Arqilenti) a nuk ta mbush mendjen se është kuptimi shqip i fjalëve: «Aq i lehtë»? Pastaj ka fjalë e kuptime fjalësh në gjuhën tonë, që nuk ua gjen shoqen as në fjalorin enciklopedik të greqishtes dhe as në gjuhën që fli-tet nga populli si fjalët: «lëndoj» (plagën), «shyt — shytë» për dhitë, e të tjera si këto.

Urania shkrihej së qeshuri me këto shakara të goditura «të Sevos së dashur» bashkë me të cilin kishin vënë dorë në hapjen e shkollës së parë shqipe të Stegopulit.

— Mendimet ia ndërpreu ndërhyrja e nënë Athinasë:

— Kam ardhur vetëm Urani, por dua të iki me ty. Emilia punon tani gjetkë mësuese, djemtë i kam të ikur. Ti duhet të vish me mua në fshat. Me siguri do të gjesh edhe punë, e s'do të kesh llafe si këtu.

Urania e pa nënën gjatë në sy. I erdhi keq për të. Ajo kishte të drejtë si nënë, por kërkesa që i bënte ajo ishte e pamundur për Uraninë.

— Unë nuk mund të vij, mama, — i tha. — Ti duhet të kuptosh se unë nuk mund ta lë rrugën time përgjysmë.

— Po ç'rrugë, moj vajzë? Të vesh në Vlorë...?

— Edhe atje do të vete..., — foli Urania pa e ngritur kokën.

— Jo, jo, kurrë! Si nuk e kupton se kështu i bën keq vetes dhe neve? Ti je dhe e sëmurë!...

— Rruga ime më e mirë është kjo që kam nisur e bërë gjer tani, mama. Ti ke mërzitje e brengë nga babai, ti ke nevojë për njerëz pranë. Por mua më duhet të shkoj drejt detyrës, siç e do e mira e shoqërisë, siç më ka porositur babai.

Këtu iu mbushën sytë me lot... Nënë e bijë biseduan shumë atë ditë, gojë më gojë. Aty nga dreka Urania e përcolli nënën gjer tek Ura e Lumit dhe e nisi në fshat me një kafshë udhe.

«DJEMTË E VAJZAT DO TË TË LARTËSOJNË, O GJIROKASTËR...»

Ulur në tavolinën e zakonshme, tek nënë Kaliopi, ku ish ulur kaq vjet me radhë, Urania kishte rënë në mendime. Bënte një monolog të brendshëm, të heshtur. Kalonte nëpër mend tërë vitet që kishin shkuar...

E akuzojnë se ka porositur nxënëset që të dalin me çorape të kushtueshme, kur vendi ishte në krizë ekonomike. Sa kontradiktore kjo shpifje me punën e fjalën e saj, me zërin e saj në mbledhjet e konferencat e grave!... «T'i forcojmë ato zakone të mira që gjer më sot i kanë mbajtur të larta e të lavdëruara femrat tona...»

E akuzojnë se me kokën e saj po përgatit me nxënëset shfaqje teatrale të padenja. Dhe kjo ndodhte pikërisht atëherë, kur teatri ishte bërë një shkollë e një tribunë e madhe edukative për vajzërinë e grarinë gjirokastrite. Kur mes tij u arrit jo vetëm të thyhen muret e errëta, që mbanin mbyllur gruan, po seksi femëror të fitojë kulturë e përparim.

E motivonin transferimin e saj nga Gjirokastra, gjoja se ajo ishte vetëm me një titull të dhënë nga

një shkollë qytetëse e Janinës. Kjo ndodhte atëherë kur Urania kish pesëmbëdhjetë vjet që shërbente në shkollat e qytetit të Gjirokastrës dhe e kish treguar veten si mësuese, si drejtoreshë, si edukatore e si organizatore shumë e zonja.

Ë mbështesnin mendimin për transferim edhe tek llafet e dëgjuaara gjoja për sjelljen e saj. Kjo ndodhte atëherë kur ajo, me punën, fjalën, rrugën e saj u bë shembull për gruan gjirokastrite. Kur, ajo me kurajon e një burri, hynte në polemikë me parinë e qytetit, dhe mbronte me forcë të drejtën e gruas.

Këto mendonte Urania në heshtje, kur hyri nënë Kaliopi.

— Dhe e vendose të shkosh në Vlorë, moj Urani? — e pyeti nënë Kaliopi duke prishur atë heshtje varri.

— Më vendosën, nënë Kaliopi.

— Kush na e bëri këtë të keqe ne, moj Urani? Ah, ju zëntë sytë puna dhe lodhja jote...! Po unë ta kam thënë: ka nierëz që e shikojnë me urrejtje punën tënde, dhe këta janë brenda në qeveri.

— Vaizëria dhe djalëria e Gjirokastrës janë të mrekullueshëm, të zgjuar, të thjeshtë, nënë Kaliopi. Ata kanë etje për dituri dhe shikim të kthjellët.

— Dhe ti e vendose të nisësh?

— Po, do të nisem.

— Vetëm, moj Urani?

— Jo, nënë Kaliopi. Me plot libra e mendime për të ardhmen e bukur që na pret. Me mendimin e asaj që bëra e që duhet ta vazhdoj dhe atje ku shkoj.

— Ne s'të lëmë vetëm, do të vijmë pas.

— Jo! S'duhet ta bëni këtë. Ti bëre shumë për

mua. Më mbajte si vajzën tënde. Edhe ti më mësove mjaft gjëra, si të eci më mirë në jetë. Unë tani di të eci.

Dhe filloi të shkruajë diçka në fletore: Ishte ndoshta shkrimi më i mirë që bënte ajo si krijuese, publiciste, pamfletiste. Ishte shkrimi i saj i fundit, përshëndetja që u bënte qytetarëve, me të cilët jeto i e punoi shumë vjet. Ajo i përshëndet ata me keqardhje të madhe, të ligjshme, se detyrohej të ikte «trupërisht» nga Gjirokastra, porse zemrën e mendjen i ka tek ajo. I ka te natyra e saj e bukur, te nxënësit që i deshi e i mësoi aq shumë, te nënat e mira gjirokastrite, me të cilat eci me guxim në rrugën e përparimit dhe të emancipimit. E ka mendjen tek djalëria e vajzëria e Gjirokastrës, që duhet të ecë kurdoherë në rrugën e virtytit, rrugë e vështirë. me plot «gjemba, gremina e mundime», por e sigurt për të çuar në të ardhmen e ndritur.

Urania u nis me dëshirën e pakufishme në zemër, që ta shohë të emancipuar femrën, që ajo të marrë pjesë në punë mendore dhe në punë krahu. Ajo iku me dëshirën që ta shihte Gjirokastrën të ndritohet e të lartësohet, siç e meritonte. Më tepër se kudo, ajo shpreh aty besimin e madh se e ardhmja është e sigurt, se «fara që mbolla me mundim e pengesa, do të lidhë lule për jetën e ardhme». Kjo bindje e plotë gjëmon fuqishëm në shkrimin e saj: «Djemtë dhe vajzat do të të lartësojnë, o Gjirokastrë. Lart e më lart ta dëgjofsha zërin tënd...!»¹⁾.

Kjo përshëndetje e fuqishme, del në shtyp atëherë kur populli i Gjirokastrës, ishte indinjuar e dëshpëruar shumë për transferimin e Uranisë, të

1) Nga muzeumi i fshatit Stegopol.

kësaj mësueseje shumë të dashur për çdo lagje, shtëpi e zemër. Përsëritetja doli atëherë kur në shtypin e kohës dolën mjaft shkrime e kërkesa nga qytetarë të ndershëm e përparimtarë, që kërkonin që ajo të mbetej atje, mbasi për udhëheqjen e saj kish shumë nevoja graria gjirokastrite.

Zëri e kërkesa e tyre nuk e ndërruan vendimin. Me shkresën rezervate 135/5 të datës 8.7.1933 të Ministrisë së Arsimit, me një karakteristikë përcjellëse tepër kontradiktore:

«Akuzat janë të shumta, provat mungojnë». Urania transferohet në Vlorë.

V
C
M
D
M
NO
VLORË

Nga fundi i tetorit 1933 Urania filloi punën si drejtoreshë e shkollës femërore në Vlorë, ku vite më parë, punoi si mësues Avni Rustemi. Në këtë periudhë të jetës së saj ajo ishte e heshtur, e menduar dhe e hequr nga shëndeti.

— Jam mësuese nga Gjirokastra, — bëri njohjen e parë me hotelxhinë e hotelit privat «Korça»...

— Dua një dhomë, të jetë e qetë.

— Je vetëm, apo me njerëz të tjerë?

— Jo, jam vetëm.

— Ç'e mirë të solli këtu, moj motër?

— Puna... Më kanë caktuar mësuese këtu.

— Mirë. mbarë e fillofsh! — e uroi hotelxhiu. që dukej një njeri tepër babaxhan. — Ja, do të kesh këtë dhomë.

Kështu nisi jeta e Uranisë në Vlorë. Shkolla ishte një godinë e vogël, që dikur kish qenë shtëpi private. Paraqitja e parë me koleget ishte tepër e thjeshtë. Vasiliqia. Varvara. Marina. Ballkëzi e deshën shumë shpejt drejtoreshën e tyre. Megjithëse

ishte shumë herë si e menduar, si e hutuar, ajo pra-
pë hyri menjëherë në zemrat e tyre.

— Ne kishim një praktikë tjetër atje, — u tha kolegeve. — Pa i prekur aspak orët e tjera të më-
simeve, zhvillonim orët e ekonomisë shtëpiake. Kjo
duhet thelluar edhe këtu. mendoj unë.

Dhe nisi punën për hartimin e një programi të
riorganizuar pune. U krijua rrethi i qëndisjes e i
qepjes, në fillim nën drejtimin e saj, pastaj nga
mësueset e tjera. Gjithnjë pak e menduar, por e
drejtë dhe korrekte, ajo e kryente detyrën si më-
suese e drejtoreshë me ndërgjegje të lartë. Si kudò
edhe këtu ajo ishte mësuese e mirë e shoqe e dashur.
Në vjetët që punoi Urania në Vlorë. shkolla u bë
gjithnjë e më tepër vatër e edukimit patriotik të
vajzave, përmes mësimit, jetës kulturore e sportive.

Ishte 9 nëntori i vitit 1934, viti i dytë si mësuese
e shkollës femërore në Vlorë. kur Urania po kthe-
hej nga vizita që kishte bërë tek një mike e saj.
Aty rreth orës gjashtë të mbrëmjes «në derën e një
ndërtese pa një grumbull cupash të shkollës së saj»¹⁾.
Kjo gjë i bëri përshtypje të madhe Uranisë. Ajo vajti
pas tyre dhe hyri brenda pas vajzave për të parë se
ç'po ndodhte aty. Sa hyri, vuri re se vajzat rrinin
në banka e dëgjonin mësimit që porsa kish filluar
të jepte mësuesja e italishtes. Urania u çudit dhe
u revoltua nga ky fakt i papritur, që i doli përpara
syve. Ajo nuk dinte të kishte ndonjë shkollë nate
në këtë qytet. E nxori në korridor mësuesen ita-
liane dhe e pyeti:

— Ç'është kjo shkollë e paditur fare nga në
këtu?...

1) A.Q.S.H. Dosja 47 16.XI.1934 Nr. 7/8. Vlorë.

— Është një shkollë e çelur me lejen e Ministrisë së Arsimit dhe, prandaj, është e lirë të frekuentohet nga çdo fëmijë shqiptari...

Urania aty për aty ia priti:

— Ju shpalljen e keni bërë për parashkollorët, unë shoh se keni regjistruar edhe fëmijë të klasave të para të fillores. Kjo nuk është e drejtë. Ata nuk i përballojnë dot mësimet në dy gjuhë.

Mësuesja italiane, duke ndier se Urania tha një të vërtetë, nuk u përgjigj fare.

Është fakt se, qysh të nesërmen e asaj dite, fëmijët filluan të mos venë më në atë shkollë.

Drejtorja shkollës këtë veprim të Urani Rumbos e bëri problem në konsullatën italiane, dhe kjo e fundit në prefekturë, duke shpifur për hyrjen e saj gjoja brutale në klasë.

Por një gjë ka rëndësi: nxënësit nuk hynë më në atë shkollë, e cila u detyrua të mbyllet. Edhe ky veprim e guxim i Uranisë flet qartë për rrugën e saj patriotike e të vendosur që ndoqi gjatë tërë praktikës së saj si mësuese e gjuhës shqipe, rrugë që e shkeli me guxim edhe e ndoqi me konsekuencë e bindje të plotë.

Po afronte nëntori i pavarësisë. Ato ditë shkollla e saj ziente nga kënga e vallja. Ditën e 28 Nëntorit Sheshi i Flamurit në Vlorë, gjëmoi nga zëri i vajzave të shkollës femërore. Ato ishin veshur me rrobat kombëtare. Ishte hera e parë që zëri i tyre gjëmonte kaq hapur dhe përpara gjithë qytetarëve.

...Tani mësuesja dilte shpeshherë anës detit dhe shënonte në fletore ditët e saj. Por këto ditë tani ishin të mërzhitura, të vrazhda, pa bukurinë e dikurshme. Edhe në vargjet e saj të reja pasqyrohej kjo gjendje shpirtërore.

«Det i qetë, det me dallgë,
 Ma ke prurë haber ca fjalë,
 Andej nga qyteti ynë,
 Ku kam lënë shpirtin tim
 Andej poshtë nga Gjirokastra,
 Ku kam mendjen unë e ngrata...»

Urania i dha shkollës një jetë tjetër në shetitjet e shpeshta, me programet e reja, me vizitat e organizuara në familjet e vajzave, me ekspozitat e punës së dorës; por shëndeti po i merrte gjithnjë e më të poshtë. Megjithëse qëndroi pak kohë në Vlorë, megjithëse ishte tepër e vrarë shpirtërisht nga akuzat dhe transferimi, ajo u bë shumë e dashur për vlonjatët. Edhe sot, në shkollën e re, të ndërtuar po aty ku ka qenë shkolla e saj, dëgjon nga goja e nxënësve të rinj të thonë: «Në shkollën tonë ka punuar mësuesja Urani Rumbol!»

*Përsëri në GJIROKASTËR **

Në vitin shkollor 1935-1936, me gjithë fjalën e doktorit për të qëndruar në pushim absolut, pa lodhje mendore, Urania vjen përsëri mësuese në Gjirokastrë, në shkollën e përzier «De Rada». Ajo zuri vend përsëri tek nënë Kaliopi. Ajo gjeti po atë ngrohtësi e dashuri nga gjithë qytetarët arsimdashës. Por brenga e mërzitja e dikurshme, larg njerëzve e punës, që e deshi aq shumë, kishte bërë punën e vet. Veç sëmundjes që kishte prej vjetësh, iu dukën shfaqjet e para të shqetësimeve nervore, aq sa nga mesi i vitit ajo u detyrua të lërë Gjirokastrën

e të shkojë në Korfuz për kurim. Dhe atje, e sëmurë rëndë, i qëndruan shumë vetë te koka. Nga Shqipëria i vinin letra të shpeshta. Ato ia dërgonin Naxhia, Hasibeja, Xhemilja, Nebaheti, Maloja, të cilat e mbanin kurdoherë pranë kujtimin e saj. Sëmundja mori zhvillim dhe së fundi më 26 mars 1936 ajo vdiq. Vdiq larg çdo gjëje që e deshi dhe për të cilën u përpoq pa kursyer. Me syrin tek e nesërmja, me mendjen tek e ardhmja e gruas shqiptare dhe me kokën të kthyer nga vendlindja e dashur i kaloi çastet e fundit të jetës së saj të shkurtër.

«Çdo herë bisedat e saj, edhe kur erdhi e sëmurë në Korfuz, ishin për femrën, për fatin e rrugën e saj, për Shqipërinë. Me Thanasin rrinin e bisedonin orë të tëra derisa ndërhynte Athinaja, që kërkonte gjithnjë ta linin Uraninë të qetë, shkruan një kushëri i saj nga Korfuza. — Ato ditë, kur u sëmur rëndë dhe doktorët e prenë çdo shpresë, më kërkoi pranë e më tha:

— Vëlla Lolo! Të vini të më thoni mbi kokë, si do të bëhet Shqipëria, si do të ecë graria shqiptare. E ndiej thellë në shpirt të ardhmen e tyre. Ndiej zërin e hapin e «flokëgjatave» të dëgjohet tok me të «flokëshkurtërve».

Ndërsa ne të tërë lotonim, ajo iu drejtua nënë Athinasë:

— Të më ruash bibliotekën, nënë! Mos qaj për mua. Vdes e bindur për të ardhmen e asaj që mendova e punova...»

U mbloodhën stegopuljotë, zagoritë e lunxhotë, që udhëtuan tërë natën që t'i jepnin lamtumirën e fundit bashkëfshatares së tyre, mësueses së dashur. Veshur me fustan të bardhë, mbushur me lule nga të marsit, që ajo i deshi shumë, dukej sikur u fliste të tërëve:

«Lart e më lart ua dëgjofsha zënë!...»

* * *

...E rëndë, e dhimbshme është vdekja. Por trimëshat nuk qahen me kuje e bëma, se ato mbi çdo dashuri kanë vënë dashurinë e madhe për At-dheun. Se nga djersa e lodhja e tyre hedh shtat një jetë e re, nga drita e syve të tyre merr dritë mëngjesi i së ardhmes.

Kështu u varros Urania, me një fjalë të thjeshtë, të sinqertë:

«...Ndahet prej nesh një nga arsimtaret më të vjetra shqiptare dhe e para në Gjirokastër. Tërë jetën ia kushtoi plot zell arsimit kombëtar, zhvillimit të jetës të shoqërisë femërore...»¹⁾

Fjalë që vinte e përgatitur nga Shqipëria, nga bashkëkohësit dhe nga nxënëset e saj. Urania hyri në çdo zemër e mendje të tyre, në çdo bisedë e gëzim, hyri e u përjetësua në këngën e popullit.

*«Stegopuli i vogël
Lindi luaneshë,
Uraninë e Rumbos
Mësuesen e thjeshtë.*

*Syrin tërë jetën
Tek femra shqiptare,
T'u mësonte shkollën,
Rrugën dritëmadhe.*

1) Gazeta «Demokracia», 4 prill 1936.

*«Zogu me një krah
Dot nuk fluturonte»,
Ndaj u ndez graria,
Prush te fjala jote.*

*Fjala jote dritë,
Endrra — dituria,
Lule motra jonë,
Motër Urania.*

*Ëndrrën sot Partia
Ta realizoi,
Krah i fortë i zogut
Lart po fluturon»¹⁾*

* * *

Kaluan pesë vjet nga vdekja e saj. Lindi dielli, Partia. Në luftën e madhe çlirimtare u derdhën në sulm vajzat tona, me yjet përmbi ballë, me pushkët supit, me ballin drejt lirisë, siç e dha kushtrimin dikur mësuese Urania duke u mësuar vazhdimisht vargjet e rilindasve tanë:

*«Kapni pushkën për liri,
Tek ju shpreson Shqipëria»*

Bulja, Fatoja, Nimetja, Ylberja, dhjetëra, qindra vajza iu ngjitën maleve për liri. U ngjitën me fjalën e Partisë në zemër dhe me pushkën në dorë.

1) Këngë popullore në gojën e të rinjve stegopuljotë sot.

Nga malet zbritën bashkë me lirinë, siç e ëndërruan patriotët, trimat e rënë, vetë Urania.

Frynë fllade të lira, të freskëta për vajzërinë: flladi i Partisë sonë, që na hapi sytë e na ndezi zemrat. Me syrin gjithmonë tek Partia, me fjalën e shokut Enver në zemër «t'i këputim kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë, për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave»¹⁾, gratë u bënë një armatë e madhe, një krah zogu plotësisht i lirë, siç deshi mësuesja. Dhe krahas burrave ato ecin përpara me kokën lart për ndërtimin e socializmit.

1) Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968», f. 8. .

NË VEND TË EPILOGUT

Nuk do të mundnim të thoshnim më tepër me fjalën tonë në këtë epilog për pioneren e arsimit tonë kombëtar, për luftëtaren e shquar të emancipimit të gruas, Urani Rumbos, se sa thonë këto rradhë të shkurtra, me domethënie të madhe, të Dekretit Nr. 3225 datë 1.3.1961, të Presidiumit të Kuvendit Popullor:

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË
REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
I JEP
URANI RUMBOS
(PAS VDEKJES)
TITULLIN
«MËSUESE E POPULLIT»
ME KËTË MOTIVACION:

«Për merita të shquara në përpjekjet për pavarësinë e Atdheut dhe për punë të palodhur në përhapjen e gjuhës amtare dhe të zgjerimit të shkollës shqipe».

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Parathënje	5
Zëri i pastër iu dëgjoftë ✓	9
Fëmijëria ✓	15
Mbresë e fortë	23
... Dua të mësoj	27
Mësuesja e parë e shqipes	38
... Lirisht do të hyj shtëpive gjirokastrite	53
Shoqe e motër për të gjithë	66
Rrethet jashtëshkollore	75
Edhe vajzat do të mësojnë muzikën e teatrin	79
Do t'i botoj në kohë të volitshme	85
S'fluturon zogu vetëm me një krah	91
Shoqëria «Përmirësimi»	94
Rruga ime më e mirë, është kjo që kam nisur	104
Djemtë e vajzat do të të lartësojnë o Gjirokastër	108
Në vend të epilogut	119

